



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:058602

Datë: 20.04.2022

Numri i dokumentit: 02934354

**PS.nr.12/21**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI SPECIAL**, në përbërje nga gjyqtarët Violeta Namani-Hajra, si kryetare e trupit gjykues, Suzana Çerkini dhe Vesel Ismajli, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.B për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.08/2020, të datës 07.04.2021, të plotësuar me datë 30.04.2021, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 16.03.2022, në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Speciale Naim Abazi, të akuzuarit R.B, me av. E.K, gjykata me datë 21.03.2022, mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë **14.04.2022**, përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**R.B**, i biri i ..... dhe nënës ....., e gjinisë ....., i lindur më ....., në fshatin ....., Komuna e ..... ,ku edhe jeton, i martuar , baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e lartë Ekonomike, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ..... lëshuar nga MPB Prishtinë.

### ËSHTË FAJTOR

**SEPSE:** Që nga data 06.07.2018 – në vazhdimësi, në cilësinë e personit zyrtar – kryetar i Komunës së ....., me dashje dhe duke shfrytëzuar autoritetin zyrtar, i ka tejkaluar kompetencat e tij duke i shkaktuar dëm shtetasit R.R dhe buxhetit të komunës së ....., në atë mënyrë që:

- Me datë 07.11.2018 ka caktuar lokacionin për ndërtimin e shkollës në fshatin ....., që fillimisht i kishte premtuar të dëmtuarin që të hyjë në marrëveshje për shkëmbimin e tokës me qëllim të ndërtimit të shkollës në fshatin ..... ku një pjesë e objektit të shkollës ishte parapa të ndërtohet në pronë private, duke anashkaluar procedurat e Kuvendit Komunal të ....., në kundërshtim edhe me nenin 11 të Ligjit nr. 04/l-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, megjithatë, ndërsa me datë 23.10.2018, ka nxjerr aktvendimin nr.01/1527, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin ..... në pjesën e ngastrës kadastrale nr.P-....., në vendin e quajtur “ ....., pronë publike, në emër të shkollës fillore “ ..... ” në ....., në sipërfaqe prej 6918m2, duke anashkaluar vendimin Nr....., të datës 04.05.2018, të nxjerr nga Kuvendi Komunal i ....., që salla e sportit në fshatin

..... të ndërtohet në oborrin e SHFMU “ .....”, megjithatë aneksi i shkollës-salla sportive nuk u ndërtua asnjëherë,

- Me datë 26.10.2018, ka nxjerr aktvendim për bartjen e mjeteve financiare nga një program në një program tjetër apo nga një kod ekonomik në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, në atë mënyrë që mjetet financiare nga kodi investime kapitale, pa miratimin paraprak të MF i ka bartur në kodin mallra dhe shërbime, e me pastaj të njëjtat mjete i ka përdorur për pagesën e detyrimeve financiare të komunës ndaj personave të tretë, pa miratimin e Kuvendit Komunal.
- Me këtë ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422, par.1 lidhur me nenin 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr.04/L082 ).

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 41, 42,43, 45,47,73, 422, par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe nenit 365, 450 dhe 463 të KPPRK-së, të pandehurin e:

### **G J Y K O N**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, i njëjti dënim me burg me pëlqimin e të pandehurit do ti zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej **5000 (pesë mijë euro)**, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari R.B, nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, Gjykata mund t’ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur 1 (një) ditë burgim, me njëzet (20) Euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari R.B, që ti paguaj të gjitha shpenzimet procedurale gjyqësore, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumë prej 100 € (njëqind euro), ndërsa shumë prej pesëdhjetë (50) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të cilët duhet t’i pagua brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari B.R me vendbanim në fshatin ....., Komuna e ....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **ARSYETIMI**

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentin Special, ka ushtruar aktakuzë PPS.nr.08/2020, të datës 07.04.2021, të plotësuar me datë 30.04.2021, kundër të akuzuarit R.B, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Kjo gjykata në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin fillestarë me datë 05.08.2021, në të cilin shqyrtim i akuzuari R.B, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ashtu që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij janë udhëzuar se kanë të drejtë në afat prej 30 ditëve nga dita e shqyrtimit fillestar të paraqes kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, ndërsa me pajtimin e palëve në procedurë seanca e shqyrtimin e dytë nuk është mbajtur.

Më datë 08.09.2021, Gjykata Themelore në Prishtinë -Departamentin Special, mori Aktvendimin PS.nr.12/21, me të cilin refuzoi si të pabazuar kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, të parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit R.B, av. E.K.

Më datë 11.10.2021, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamentin Special, mori Aktvendim PN.S.nr.54/21, të datës 11.10.2021, ku ka refuzuar si të pabazuar Ankesën e mbrojtësi të pandehurit R.B, av.E.K, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, PS.nr.12/21, të datës 08.09.2021.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe pas leximit të aktakuzës nga Prokurori Speciale, i akuzuari R.B, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar dhe meqë i akuzuari nuk e ka pranuar kryerje e kësaj vepre penale, Gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPPRK-së, ka vazhduar seancën e shqyrtimit gjyqësor me prezantimin e provave dhe fjalën përfundimtare.

### **Fjalët përfundimtare palëve dhe mbrojtja e të akuzuarit**

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare, të paraqitur në formë të shkruar dhe të elaboruar me gojë në shqyrtim ka theksuar se në këtë çështje penale, në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë dhe se në bazë të kësaj gjendje faktike në mënyrë të qartë u vërtetua se në veprimet e të akuzuarit, manifestohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilat është akuzuar, se i akuzuari ka vepruar me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore apo çfarëdo dobie tjetër për veti apo për tjetrin, dhe se me këtë i është shkaktuar dëm shtetasit R.R dhe buxhetit të Komunës së ..... Më tutje ka bërë përshkrimin e dëshmive të dëshmitareve B.R rreth ndërtimit të shkollës në pronën e tij, në mungesë të kompensimit, me pronë tjetër, siç kishte kërkuar dhe i ishte premtuar nga tani i akuzuari R.B në cilësinë e kryetarit të Komunës së .....; dëshminë e dëshmitarit A.K i cili ka dëshmuar lidhur me bartjen e mjeteve financiare nga një kategori në tjetrën, e cila bartje mund të behet vetëm nga Kuvendi Komunal, pastaj projektet, projektin me kod 42006 me shumë të realizimit prej 58.901 euro e 48 cent, projektin e kanalizimit në rrugën ‘Mulla Selimi’, fshati ‘ ..... ’, i cili projekt bartë numrin 42007, në vlerë prej 14.000 euro, projekti për ndërtimin e rrugës periferike mini tranzit në ....., i cili bart kodit 46723 në vlerë prej 493.000 euro, që ndërlidhin projektin mini-tranzitit, që ka kushtuar 500.000 euro, të cilat edhe pse kane figuruar si të realizuara, nuk janë realizuar, dhe se lidhur me të njëjtën nuk është zhvilluar fare procedurë tenderimi; pastaj deklarimeve të ekspertit A.SH, i cili ka qëndruar në tërësi pas konstatimeve në ekspertizën e datës 17.22.2020. Më tutje ka bërë përshkrimin e të gjitha provave materiale të administruara, të cilave ka kërkuar të ju falet besimi, duke u ndalur pastaj në elaburimin e figurës së veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 par.1, lidhur me nenin 81, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, që në rastin e të akuzuarit R.B është manifestuar në formën e tejkalimit të kompetencave duke e anashkaluar Kuvendin Komunal dhe buxhetin e miratuar nga Kuvendi Komunal, përmes një varg veprimesh, siç janë fillimi i ndërtimit të shkollës në pronë private pa ndjekur procedurat e parapara me ligj, në njërin anë, e anën tjetër duke i shkaktuar dëm pronarit të tokës për shkak të mos kompensimit; ndërrimi lokacionit të ndërtimit të sallës së sporteve në fshatin ..... në kundërshtim me vendimin e KK ....., si dhe bartja e parasë publike nga një program në programin tjetër, dhe pagesa e shpenzimeve të ndryshme në emër të investimeve kapitale për projektet përkatëse. Në këto rrethana të vërtetuara, i ka propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohen sipas Kodit në fuqi dhe të obligohen në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa që si rrethanë rënduese me rastin e caktimit të dënimit të marr peshën e veprës penale, përgjegjësinë penale, rrezikshmëria shoqërore, dhe shumë rrethana të tjera rënduese, por nëse ekzistojnë të marr parasysh edhe rrethanat lehtësuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.B, av.E.K në fjalën përfundimtare të paraqitur në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht në shqyrtim gjyqësor, ka theksuar se nga provat e administruar nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, duke shtuar se

gjatë gjithë veprimeve të tij në cilësinë e kryetarit të Komunës, ka vepruar në pajtim me ligjin, përfshirë këtu edhe vendimet për dhënie e në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, pastaj për ndërtimin e sallës Sportive në shkollën “ .....” në fshatin ....., si dhe për bartjen e mjeteve financiare nga një kod në kodin tjetër buxhetor. Më tutje ka shtuar sa i përket vendimit të Kuvendit Komunal nr.02/135 dt.04.05.2018, për ndërtimin e sallës së Sporteve në oborrin e shkollës fillore “ .....”, në fshatin ....., ka pasur mosmarrëveshje ndërmjet banorëve të fshatit lidhur me vendin e ndërtimit, dhe siç është vargëtuar dhe nga dëshmia e dëshmitarit M.M, kjo ka qenë arsyeja pse Ministria ka tërhequr fondet për ndërtim, mirëpo që me këtë Komunës nuk i është shkaktuar asnjë dëm. Po ashtu ka shtuar sa i përket ndërtimit të shkollës në fshatin ....., me këtë rast janë respektuar dispozitat ligjore, i mbrojturi i tij ka bërë kërkesë në Kuvendin Komunal, mirëpo që Kuvendi Komunal kishte refuzuar, por siç e ka shpjeguar i mbrojturi i tij, vendosja e gurthemelit pa u miratuar paraprakisht në Kuvendin Komunal ka ndodhur për shkak të rrezikut të humbjes së fondeve në rast të mos shfrytëzimit të tyre, për më tepër që tani dëshmitari B.R siç e ka pohuar dhe vetë në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor e ka dhënë pëlqimin për ndërtimin e shkollës në një pjesë të tokës së tij, pasi që i ishte dhënë premtimi që toka e marr do i kompensohet me pronë publike, rrethanë kjo e vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarit RR.M, ndërsa që nga dëshmitarët N.SH dhe B.K, është vërtetuar se nuk ka pasur shkelje gjatë procedurës së prokurimit për ndërtimin e shkollës në fshatin ..... Po ashtu lidhur me transferimin të mjeteve financiare nga një kod buxhetor në tjetrin, siç është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit V.M, ka ardhur si rrjedhojë e detyrimeve financiare të krijuara nga Komuna, vonesa në pagimin e të cilave do të krijonte obligime shtesë, dhe se me këto veprime i akuzuari R.B ka mbrojtur buxhetin e Komunës, nga futja në obligime të mëtejme, ndërsa që në anën tjetër askush nuk ka përfituar në mënyrë të kundërligjshme. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të mbrojturin e tij, në mungesë të provave, ta liron nga aktakuza.

I akuzuari R.B, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, e ka shfrytëzuar të drejtën që të mos deklarohet, në këtë çështje penale, ndërsa që në deklaratat e dhëna në procedurë paraprake, përkatësisht në deklaratë e dhëna në Polici me datë 23.07.2019 dhe me datë 09.02.2021 ka deklaruar se në cilësinë e Kryetarit të Komunës së ..... është i zgjedhur që nga viti 2013 dhe pastaj ka sqaruar projektet konkrete duke filluar nga projekti i shkollës e .....-it, për të cilën ka theksuar se ka qenë i miratuar në Kuvendin Komunal në projektbuxhetin 2018-2020, në vitin 2018 janë ndara 170,000.00 euro nga Kuvendi për ndërtimin e kësaj shkolle, për shkak të zvarritjes së procedurave të prokurimit projekti është vonuar deri në muajin tetor 2018, në fund të muajit tetor është lidhur kontrata dhe kanë qenë të detyruar ti krijojnë kushte operatorit për ti filluar punimet, një pjesë e buxhetit ka qenë e paraparë për vitin 2019, ku e ka zbatuar një vendim Ref.02/341 i datës 21.09.2017 të Kuvendit për implementimin e atij projekti i paraparë në buxhet. Më tutje ka shtuar se në pamundësinë për gjetjen e pozitës së përshtatshme për ndërtimin e shkollës në pronën e Komunës, i ka ftuar kryesuesin e Kuvendit Komunal në ..... RR.M dhe pronarin e tokës private B.R dhe zyrtarin ligjor M.M, ku një pjesë e sipërfaqes së shkollës ka rastisë të bjerë në pronën e R.R, objekti i shkollës rreth 85% është vendosur në pronën e komunës rreth 15 % i bije në pronë private, që ndaj pronarit të kompensohet prona me pronë ashtu siç thotë ligji, po atë ditë është thirr mbledhja e Kuvendit me datë 06.11.2018 dhe me datë 07.11.2018 është vendosur gur themelin i shkollës, procedura e këmbimit të pronës me pronë ende nuk është përfunduar sepse Kuvendi Komunal nuk e ka miratuar për arsye politike, edhe pse shtatë herë e kanë dërguar në Kuvend për miratim. Ka theksuar se nuk ka pasur asnjë ankesë nga pronari, me të cilën është bërë marrëveshja gojore, që sipas tij është kontratë, dhe arsyeja e fillimit të ndërtimit të shkollës pa përfundimin procedurës së parapara ligjore lidhur me këmbimin e tokës publike me private, është se punë kryesit pas lidhjes së kontratës kanë kërkuar që të fillojnë punën dhe është dashur të sigurohen kushte për të filluar punën, se ka besuar që Kuvendi Komunal do veprojnë sipas kërkesës së paraqitur nr. 01/1597

të datës 06.11.2018 dhe se marrëveshje gojore është e mjaftueshme, se është dashur që procedura e këmbimit të pronës publike me private të miratohet nga Kuvendi, dhe se është filluar procedura në bazë të ligjit nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunë, por ende nuk është përfunduar, derisa që ndërtimi i shkollës ka përfunduar, por nuk është bërë pranimi teknik. Sa i përket aktvendimit të datës 26.10.2018 të protokolluar me numër 01-1559 për lëvizje të projekteve dhe pagesave të tyre nga programi në program, ka theksuar se ka qenë fundi i vitit dhe ka pasur mungesë të fondeve, është bërë për shkak të ruajtjes së interesit të komunës, si dhe të gjitha projektet kanë qenë të miratuara në kuvend dhe bartja është bërë në projekte të kuvendit. Më tutje sa i përket mos zbatimit të vendimit të Kuvendit Komunal në ..... të datës 04.05.2018, me numër 02/135, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve në oborrin e SHMU “.....” në ....., ka theksuar se kërkesa e tij ka qenë që salla e sportit të ndërtohet tek shkolla “.....” në ....., pasi që kjo shkollë i ka 346 nxënës ndërsa shkolla “.....”, i ka 200 nxënës, pastaj shkolla ..... është në qendër të fshatit dhe ka qenë numri më i madh i nxënësve, ndërsa që Kuvendi Komunal është bazuar në kërkesën e kryesisë së fshatit ....., ku është proceduar kjo kërkesë dhe Kuvendi ka marrë vendim që sallën e sportit ta ndërtoj te shkolla “.....” në ....., dhe lidhur me mos ndërtimin e sallës së sporteve nga Ministria e Kulturës, nuk e ka njoftuar Ministrinë e Kulturës, për shkak të zvarritjes së procedurave nga ana e kuvendit, si dhe e kishte konfirmuar se nuk është ndërtuar salla e sportit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

### **Provat e administruara në shqyrtim gjyqësor**

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktik në këtë çështje penale, gjykata ka dëgjuar të dëmtuarin/dëshmitarin B.R, dëshmitarët A.M, V.K, A.K, RR.M, V.M, N.SHj, B.K, M.M, ekspertin A.SH, dhe ka administruar provat materiale: Planifikimi përfundimtar i prokurimit për vitin 2018, i Komunën e ....., i datë 01.02.2018; kërkesa për përgatitjen e dokumentacionit lidhur me projektin kapital “Salla e sportit në ..... të .....” nr. 261/2018, i datës 30.01.2018, e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Raport Nr.07/2018, datë 07.02.2018, për caktimin e vendit të ndërtimit të sallës së sporteve; kërkesa Nr.01/211, i datës 12.02.2018, shqyrtim dhe marrje të vendimit për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sporteve në fshatin ..... K.K .....; Vendim Nr.01/261, i datës 21.02.2018, i kryetarit të komunës së ....., R.B; Procesverbali i shkruar me dorë nga kryesia e fshatit ....., për caktimin e vendit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin .....; Vendimi i Kuvendit Komunal nr.02/134 i dt.04.05.2018; Vendim Nr.02/135, e datës 04.05.2018, për caktimin e vendit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin .....; Kontratë prokurimi Nr.79, me shenjen Nr.03/123 e datës 26.10.2018, shkresa-Infomim për lëvizjen e nxënësve nga SHFMU “.....” e datës 15.05.2019 nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e .....; njoftimi i datës 24.05.2018, mbi ecurinë e punimeve për projektin “punimi i kanalizimit nëpër fshatrat e komunës së .....”; kërkesa Nr.02/171, të datës 29.05.2018, e paraqitur Kryetari i Komunës R.B, për Kuvendin e Komunës së .....; aktvendimi për iniciimin e procedurave të prokurimit, Nr.01/1097, të datës 24.07.2018, i nxjerr nga Kryetari R.B; Përgjigje Nr.Prot.104, të datës 25.07.2018, e Ministrisë së Financave; Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmëris së fondeve të datës 09.08.2018; aktvendimi nr.01/1527 i datës 23.10.2018, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin .....; Njoftimi Nr.03/123, të datës 26.10.2018, për shpenzimet e buxhetit janar-shtator 2018, nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa; Aktvendimi Nr.01-1559, i datës 29.10.2018, i nxjerr nga kryetari i Komunës R.B; Kërkesa Nr.01-1597, të datës 06.11.2018 për marrjen e vendimit për ndërrimin e pronës publike në pronë private; kërkesa e Kuvendit Komunal në ....., drejtuar Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, për përdorim të autoritetit, nr.2 e datës 15.11.2018; Përgjigja Nr.020-1374, e datës 06.12.2018, e Qeveris së Kosovës-Ministria e Administrimit të Pushtetit

Lokal; Raporti i punimeve për projektin “Shkolla fillore në ....., i datës 15.05.2018 (2019), i përpiluar nga Menaxheri i projektit J.K; Kopje e planit të parcelës për ndërtimin e shkollës në ....., i datës 23.05.2018, Agjencia Kadastrale, Njoftim për kryetarin e komunës, i datës 06.06.2019, Drejtoria për Buxhet dhe Financa; Nga njoftim Nr.04-122, i datës 04.07.2019, nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa-Komuna e .....; Kërkesë e biznesit NT “ALFA” drejtuar Ministrisë së Financave për pagesë për shkak të mos kryerjes së pagesës në shumë prej 25,036.83 euro nga komuna e ..... (me dosje e kompletuar për pagesë) Nr.4019, i datës 01.11.2019, Biznesi, NT “ALFA”, Procesverbalet mbledhjeve të Kuvendit Komunal në Komunën e .....: Nr.02/283, datë 14.05.2019; Nr.02/461, datë 07.11.2018; Nr.02/489 datë 23.11.2018; Nr.02/489 datë 23.11.2018; Nr.02/508, datë 04.12.2018; Nr.02/508, datë 04.12.2018, Nr.02/583, datë 31.12.2018; Nr.02/146, datë 23.01.2019; Nr.02/107 datë 22.02.2019; Nr.02/189 datë 22.03.2019; Procesverbal Nr.02/194 datë 22.03.2019; Nr.02/341 datë 05.06.2019; Nr.02/345 datë 10.06.2019, Nr.02/285 dt.13.05.2019, Shkresa Nr.02/367, Nr.02/367, datë 20.06.2016, Nr.025/189 datë 22.03.2019, Procesverbal Nr.02/549 i datës 10.09.2019, Nr.02/461, datë 07.11.2018; Nr.02/489, datë 23.11.2018; Nr.02/46, datë 23.01.2019; Nr.02/107, datë 22.09.2019, thirrja e mbledhjes e VI-të Nr.02/171 e datës 29.05.2018, e Kuvendit Komunal në ....., dhe Ekspertiza e ekspertit financiar A.SH e datës 17.11.2020.

Gjykata konform nenit 7 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të pandehurit, si dhe ato në favor të tij, duke i mundur të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje, i vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerr përfundim lidhur me faktet konkrete të vërtetuara, ashtu që pas administrimit të provave vërtetoi këtë gjendje faktike.

**Dëshmitari B.R.**, në deklaratë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 24.01.2022, fillimisht ka deklaruar se qëndron pran deklaratave të dhëna në Polici me datë 19.07.2019 dhe datë 03.03.2021, dhe ka shtuar se disa zyrtar të Komunës kur janë dalë në teren në fshatin .....-Rud, kane kërkuar prej familjes tonë që të lirohet një pjesë e pronës prej 8 ari e gjysmë për ndërtimin e shkollës, fillimisht nuk ka pranuar, pas që ka jetuar në bashkësi familjare, janë 5 vëllezër, dhe tre vëllezërit që janë jashtë vendit e kanë shtyrë me pranua, se i kanë thënë se është marre mos me dhënë toka me ndërtua shkolla duke marrë parasysh se dhe ai punon si mësues në atë shkollë, vëllezërit kanë pranuar me u ndërtuar shkolla në atë pjesë të pronës me kusht që me u kompensuar jo më pare, por me tokë të njëjtë, aty afër, pasi që ngjit me tokën e tyre është prona shtetërore dhe për këtë kanë pasur marrëveshje verbale me kryetarin R.B, e sa i kujtohet aty prezent ka qenë dhe kryesuesi i Kuvendit RR.M, që të bëhet ndërtimi i shkollës dhe të bëhet kompensimi me pronë tjetër dhe janë pajtuar që çështja të shkoj përmes asamblesë, i ka pohuar kryetarin se nuk pranojnë 1 ari me 1 ari me i kompensua, por pranojnë vetëm kompensimin 3 ari për 1 ari, kryetari nuk ju ka premtua për çfarë vlere të tokës do të kompensohet toka e tyre, mirëpo që kompensimi do të kryhet dhe vetë ka qenë i bindur se shteti nuk mundet me ia marrë pasurinë e mos me i'a dhënë asnjë kompensim dhe se lidhur me këtë çështje me kryetarin tani të akuzuarin R.B Bega, ka biseduar njëherë në zyre të tij dhe njëherë në fshat, në oborrin e shkollës dhe janë pajtuar që procedura e kompensimi të shkoj përmes asamblesë Komonale. Më tutje ka sqaruar se tani pas ndarjes së tokës, toka ku është ndërtuar sholla, është në emër të vëllait të madh R.R, mirëpo që në kohen kur është marr toka për ndërtim, të gjithë vëllezërit tjerë kanë qenë jashtë vendit, dhe ai e ka konsideruar veten si pronar të saj, dhe arsyeja pse është marr prona e tyre, për ndërtim të shkollës është se pozicioni në vendin ku është shkolla, pasi që ku është prona shtetërore është pozita tepër e pjerrët dhe është e pa mundshme me ndërtua shkollën aty sepse është e ngushtë dhe shumë e pjerrët, ndërsa shkollë të vjetër që është edhe sot funksionale, nuk i përmbush kërkesat sepse punon në dy ndërrime, ka pas mungesë të hapësirës, ndërsa që shkolla

e re ende nuk është funksionale, vetëm inventari i mungon. Po ashtu ka shtuar se me ndërtimin e shkollës, ju është vështirësuar qasja pasi që duhet të kalojnë nëpër pronë të shtetit, për të lidhur me rrugë nga shtëpia e tyre, pastaj, duke qenë se shkolla është vetëm 20 metra nga shtëpia e vëllai të tij, dëgjohet zhurma e nxënëse, por sido që të jetë, presion nuk ka pas prej ndokujt për me dhënë tokën, padi për kompensim nuk ka paraqitur sepse është marr veshë me kryetarin, kush e ka iniciuar rastin në gjykatë nuk e din, mirëpo në të ardhmen nëse nuk gjendet zgjidhje për kompensim, atëherë duhet me shkuar përmes gjykatës. Në deklaratat e dhënë në Polici me datë 19.07.2019 dhe me datë 03.03.2021, ka deklaruar ngjashëm lidhur me rrethanat për të cila është deklaruar në këtë çështje penale.

Gjykata vlerëson dëshmitë e dëshmitarit B.R, dëshmi të cilën e ka vlerësuar si të sinqertë dhe objektive, e cila si e tillë është në përputhje me provat materiale, dëshmitë e dëshmitarëve tjerë dhe me deklarata që ky dëshmitar ka dhënë në procedurën paraprake, e nga e cila dëshmi ka vërtetuar bindshëm faktin se tani dëshmitarit B.R, i është marr sipërfaqja prej 836 m2 në të cilën është ndërtuar një pjesë e objektit shkollor, në mungesë kompensimit, përkatësisht pa kaluar në procedurën e kompensimit apo këmbimit të tokës më tokë, për çka deri me tani ky dëshmitar ende nuk është kompensuar për token e marrur, derisa që kishte lidhur një marrëveshje gojore me tani të akuzuarin R.B, anipse i akuzuari R.B, nuk ka pasur autorizime ligjore për të hyre në detyrime të tilla, e të i krijoj obligime financiare Komunes së ....., përderisa Kuvendi Komunal nuk ka marr vendim, për shpalljen e asaj sipërfaqe si zona me interes të veçantë. Gjykata, pohimin e këtij dëshmitari se nuk është i dëmtuar, e konsideron një pohim në funksion të lehtësimit të përgjegjëse penale të tani të akuzuarit R.B, pasi që i njëjti në vazhdimësi gjatë dëshmisë së tij, ka pohuar se nuk është kompensuar, se ka pranuar të ndërtohet objekti në shkollor në një pjesë të pronës së tij, vetëm pas arritjes së marrëveshjes gojore me tani të akuzuarit R.B, dhe se pret të kompensohet, derisa që objekti shkollor tani më është ndërtuar në tërësi.

**Dëshmitari V.K** në deklaratë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 26.01.2022, ka deklaruar se është asamblist në Kuvendin Komunal në ....., nga viti 2017, e që gjatë kësaj periudhë ka qenë shef i grupit parlamentar të LDK-së, anëtarë i komitetit për politike dhe financa, të cilin komitet e përfaqëson kryesuesi i kuvendit komunal, ndërsa që ai si anëtar i komitetit për politikë dhe financa, detyra e tij ka qenë harmonizimi i programit të punëve, i pikave të rendit të ditës në seanca, ndërsa që është ekzekutimi që ka të bëjë me çështje financiare, anipse quhet komiteti për buxhet dhe financë. Më tutej ka shtuar se sa i përket ndërtimit të palestrës sportive, janë zhvilluar dhe takime e konsultime edhe me komunitetin në fshatin ....., ku ka qenë prezent edhe kryetari Begaj, Kuvendi me shumica votash ka vendosë që kjo palestër sportive të ndërtohet në shkollën “.....”, në ....., mirëpo edhe sot e kësaj dite ajo palestër nuk është ndërtua, me arsyetimin se është premtuar të ndërtohet në një shkollë tjetër, për shkak se kanë thënë që ai projekt i ka takua dikujt tjetër dhe kështu ka mbet pa u ndërtua fare, ndërsa ka dëgjuar për shkollën që është ndërtuar në fshatin ....., që kanë dalur disa problem me pronë, mirëpo nuk ka njohuri se çka ka ndodhur më tutje. Po ashtu ka shtuar se për shkakun se nuk është ekonomist me profesion, nuk është në kompetencën e tij të di se si shkon procedura e lëvizjes se kodeve prej një kodi në kodin tjetër, mirëpo që beson se lëvizja nga një projekt në tjetrin mund të bëhet vetëm nga Kuvendi Komunal, pas që më parë çështja është diskutuar në komitetin për politikë dhe financa, nga i cili komitet edhe rrjedh rekomandimi që votohet në Kuvend. Nuk i është kujtuar ndonjë projekt konkret, mirëpo që ka pasur vërejtje, ankesa nga komiteti për politikë dhe financa për raportin vjetor për buxhet dhe financa për vitin 2018, për shkak të mos implementimeve të disa projekteve, largimit të disa projekteve edhe devijimit të disa projekteve tjera, dhe se përgjegjës për mos implementimin e projekteve në rastin konkret palestra sportive, apo mos ndërtimin e rrugës është përgjegjës ekzekutivi-kryetari, secilin projekt që e miraton shumica e kuvendit mbrohet me ligj dhe me rregullore, dhe se ka dëshmi se ka pas shumë

projekte ku në vend të një rrugë është shtrua një rrugë tjetër, shumë projekte që nuk janë realizuar farën ose nuk janë realizuar me kohë. Ka deklaruar se mbetet pran deklaratës të dhënë në polici me datën më datë 06.05.2019, në të cilën deklaratë ka deklaruar ngjashëm sikurse edhe në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari, të cilën dëshmi e ka vlerësuar si dëshmi të singertë dhe objektive, e cila si e tillë është në përputhje me deklaratën e dhënë në procedurë paraprake dhe me prova tjera materiale, nga e cila dëshmi ka vërtetuar bindshme faktin se i akuzuari R.B, në cilësinë e kryetari të Komunës edhe pasi Kuvendit Komunal ka vendosur për ndërtimin e palestrës sportive në shkollën “.....”, në ....., ka refuzuar ta zbatoj të njëjtin, duke mos vepruar kështu në pajtim me Vendimet e Kuvendit Komunal, zbatimin e të cilave e ka pasur detyrim ligjor, për me tepër ka nxjerr vendim duke anashkaluar vendimin e Kuvendit Komunal, dhe ka vendosur që salla sportive të ndërtohet në oborin e shkollës “.....” në fshatin ..... E po ashtu, nga dëshmia e këtij dëshmitari, vërtetohet bindshme fakti se i akuzuari R.B, në cilësinë e kryetarit të Komunës, ka tejkaluar kompetencat ligjore, ashtu që duke anashkaluar Kuvendin Komunal, ka vendosur lëvizjen e mjeteve financiare, prej një kodi në kodin tjetër buxhetor, pa miratimin paraprak të Kuvendit Komunal, që siç ka dëshmuar ky dëshmitari ka qenë praktik e zakonshme, që gjithsecili propozim të diskutohet fillimisht në komitetin për politik dhe Financa, dhe pastaj të miratohet në Kuvend, çka vërteton faktin se i akuzuari R.B ka qenë në dijeni të këtij detyrimi ligjor, por me dashje e ka shmangur të njëjtin duke i tejkaluara autorizimet e tij e duke uzurpuar autorizimet ligjore të një organi tjetër, në këtë rast të Kuvendit Komunal në .....

**Dëshmitari N.SH** në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 26.01.2022, ka deklaruar se në aktvendimin e quajtur për procedura të prokurimit të protokolluar me datë 24.07.2018, me nr.01/1097 në fq.3 tek, figuron emri i tij si menaxher i prokurimit, mirëpo që nënshkrimi është bërë zyrtarë i prokurimit B.K me autorizim të kryetari të komunës, pasi që në atë kohë dëshmitari ka qenë në kontratë pune “kontratë mbi vepër” dhe nuk kam pasur të drejtë me nënshkrua kontratë të tillë, ndërsa emri i tij ka qenë, pasi që ka qenë i emëruar si menaxher i prokurimit, po pa të drejtë nënshkrimi të kontratave. Po ashtu ka shtuar sa i përket kontratës me nr.79 e protokolluar me datës 26.10.2018, me nr. 03/123, në të cilën figuron emri i tij si menaxher i prokurimit, situatë është e njëjta, figuron emri i tij si menaxher i prokurimit, mirëpo pa të drejtë nënshkrimi, pasi që nuk ka pasur pas të drejtë për të nënshkruar, derisa që sot punon me kontratë të rregullt dhe është i licencuar nga viti 2019, po edhe sot ka raste që vendoset emri i tij si menaxher, ndërsa në rast mungesës autorizohet dikush për të dhënë nënshkrim në vendin e tij, në vlera të mëdha nënshkruhet dëshmitari dhe ZKA, ndërsa në vlera të vogla dhe të mesme nënshkrimin e jep i vetëm. Në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me datë 24.02.2021, ka deklaruar ngjashëm për rrethanat për të cilat është pyetur.

**Dëshmitari B.K** në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 26.01.2022, ka deklaruar se që nga viti 2018 është zyrtarë i prokurimit, dhe i kujtohet procedura e prokurimit e zhvilluar lidhur me objektin e shkollës fillore në fshatin ....., Komuna ....., menaxher i prokurimit ka qenë N.SH, mirëpo pasi që nuk ka qenë i licencuar për nënshkrime, është e caktuar nga prokurimi të shënohet emri i menaxherit, ndërsa ai kam qenë i autorizuar nga kryetari që ta ushtroj atë funksion vetëm për nënshkrime që mos me mbet procedura keq deri sa të bëhet certifikimi i menaxherit të prokurimit, pasi që asnjë projekt nuk bëhet pa emër të menaxherit të prokurimit dhe pa nënshkrim të zyrtarit të certifikuar. Më tutje ka shtuar se para se të nënshkruhet kontrata e lartcekur si zyrtar i prokurimit, projekt për ndërtimin e shkollës nuk ka pas, para-masat kanë qenë si ka me u duk shkolla, që është dashtë me u ndërtua në fshatin ....., mirëpo vendin saktë i ndërtimit nuk ka figurë, dhe as që ka qenë kompetencë e zyrës së prokurimit me



ditë vendin e ndërtimit, përderisa ka konstatuar se dosjen e tenderit ka qenë në rregull, duke shtuar se ka qenë kërkesa e drejtorisë së arsimit për fillimin e procedurës, e pas kësaj kërkesë bëhen para masat-specifikat, kërkesa shkon tek kryetari për vendim dhe të Drejtoria e financave për zotim të mjeteve dhe pas 1 viti vjen në prokurim për fillimin e procedurës. Ka deklaruar se mbetet në tërësi pran deklaratës së dhëna në procedurën paraprake, përkatësisht deklaratës së dhënë në Polici me datë 24.02.2021, në të cilën ngjashëm ka deklaruar sikurse dhe në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata ka vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve N.SH dhe B.K të cilat dëshmi i ka vlerësuar si pjesërisht objektive dhe të sinqerta, edhe atë vetëm sa i përket faktit që vërtetë, me rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit lidhur me ndërtimin e objektit të shkollës fillore në fshatin ....., Komuna ....., tani dëshmitari B.K-zyrtar i prokurimit është nënshkruar në emër të tani dëshmitarit N.SH-menaxher i prokurimit, sipas autorizimit të dhënë nga tani i akuzuarit R.B Bega, në cilësinë e kryetarit të Komunës së ....., mirëpo që sa i përket pjesë tjetër të dëshmisë së këtyre dëshmitareve, se dosja e tenderit ka qenë në rregull, anipse siç e ka pohuar vetë dëshmitari Besnik, projekt për ndërtim të shkollës nuk ka pas, apo se ekziston mundësi ligjore e caktimit si menaxher i prokurimit, por pa të drejt nënshkrimi, gjykata vlerëson se këto pohime nuk qëndrojnë, janë të pa vërteta dhe të paarsyeshme, pasi që jo vetëm këta dëshmitar nuk ka qenë në gjendje të i referohen bazës ligjor që parasheh një mundësi të tillë, “menaxher i prokurimit, por pa të drejt nënshkrimi”, mirëpo të qenit menaxher i prokurimit për veç autorizimeve të caktuara, ekzistojnë edhe përgjegjësi për zhvillimin e procedurave dhe pjesën implemetuese të projekteve të caktuara, dhe se kjo përgjegjësi lidhet qenësisht me aktin e nënshkrimit të dokumentit të caktuar, me që rast edhe mirren përgjegjësit dhe obligimet e caktuara që dalin nga një akt i tillë i nënshkruar. Një situatë e tillë, e të qenit “menaxher i prokurimit, por pa të drejt nënshkrimi”, jo vetëm është një situatë ekstra ligjore, por është edhe jo logjike, e cila si e tillë do të rezultonte me situatë absurde, edhe pse ndoshta në funksion të ikjes së përgjegjësisë, mirë të mendueshme, pasi që në të tilla raste, menaxheri do të pohonte se nuk e ka nënshkruar kontratën, siç e pohon edhe ky dëshmitari, ndërsa që nënshkruese, do pohonte se nuk ka qenë menaxher i prokurimit apo i projektit të caktuar, por vetëm e ka nënshkruar.

**Dëshmitari A.K** në deklaratë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 03.02.2022, ka deklaruar se gjatë mandatit të kaluar ka qenë asamblist në Kuvendin Komunal të ..... dhe ka qenë anëtarë i komitetit për politika dhe financa nga lëvizja Vetëvendosje, i cili Komitet shqyrton të gjitha dokumentet strategjike, kërkesat të cilat i drejtohen kuvendit komunal. Më tutje ka shtuar se për vendimin e datës 26.10.2018, dhe datë 29.10.2018, me numër 01/1559, i nxjerrë nga kryetari i komunës së ....., për bartjen e mjeteve financiare nga një kod ekonomik në kod tjetër, e ka kuptuar nga web-faqja e Komunës së ....., edhe pse sipas ligjit për vetëqeverisje lokale për përgjegjësi të Kuvendit Komunal dhe kryetarit dhe ligjit për financa publike është e qartësuar se bartjen e këtyre mjeteve mundë ta bëjë vetëm kuvendi komunal me vendim, e që në rastin konkretë nuk ka ndodhur dhe nuk ju është kërkuar asnjëherë nga kryetari që Kuvendi Komunal të vendos lidhur me këtë çështje, ndërsa që nuk i kujtohet të i jetë dorëzuar komitetit për politika dhe financa, ndonjë raport financiar për vitin 2018. Po ashtu ka shtuar se sa u përket projektit me kod 42006 me shumë të realizimit prej 58.901 euro e 48 cent, projektin e kanalizimit në rrugën “Mulla Selimi”, fshati “.....”, i cili projekt bartë numrin 42007, në vlerë prej 14.000 euro, projekti për ndërtimin e rrugës periferike mini-transit në ....., i cili bart kodit 46723 në vlerë prej 493.000 euro, pas njoftimit lidhur me të njëjtat përmes një raporti financiar nga Drejtoria e Financave, ku ka figuruar si projekt i realizuar mbi 99 %, ka shkuar personalisht në vendin e ngjarjes, dhe e ka kuptuar se ky projekt nuk është realizuar fare, dhe nga sistemi elektronik i KRPP-së, është kuptuar se një projekt i tillë nuk është tenderuar, e që kjo ka ngritur dyshim, për çka të gjitha materialet i kanë dërguar në Polici. Më tutje ka shtuar se lidhur me

vendimin e datës 04.05.2018 me numër 02/135 të nxjerr nga Kuvendi Komunal i ....., që ka të bëjë me ndërtimin e sallës sportive në shkollën e mesme e ulët “.....” në fshatin ....., ka pasur pakënaqësi lidhur me përzgjedhjen e lokacionit pa përfshirjen e qytetarëve, kërkesa ka shkuar në Kuvendin Komunal, ku edhe është kuptuar se mjetet për ndërtimin e sajë do të vijnë nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, kuvendi ka marr vendim që lokacioni të jetë në oborrin e shkollës “.....”, vendimi nuk është zbatuar, mjete të cilat kanë qenë të ndara prej ministrisë, janë tërheqë nga e njëjta, mjetet e ndara të Komunës janë bartur nga kryetari në projekte të tjera, pa vendim të Kuvendit. Më tutje ka shtuar se lidhur me ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Panovc, nuk kemi pasur asnjë kërkesë nga kryetari për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e kësaj shkolle, anipse kur s’ka plan zhvillimor komunal, atëherë është vetëm kuvendi komunal që merr vendim për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e objektit dhe tek kur ka filluar policia të hetoj, çështja është sjell në Kuvend Komunal për ndërrimin e destinimit, ku nuk ka pas të bëjë me caktim e lokacionit por me këmbimin e pronës nga prona private në pronë publike, pasi ka filluar ndërtimi i shkollës. Pastaj ka shtuar se ndërtimin e kësaj shkolle nuk e ka justifikuar dhe numri i vogël i nxënësve që vijnë në mesimin në shkollën e cila gjithashtu i ka plotësuar kushtet për mesim-mbajtje, dhe se siç ka rezultuar nga të dhënat e nxjerra nga E-Prokurimi, me rastin e tenderimit, janë përcaktuar vetëm para masa dhe para llogaria, dhe as një element tjetër, përfshirë edhe lokacionin e ndërtimit, e që këto parregullsi janë evidentuar edhe në raportin e auditorit për vitin 2019, ku konstatohet se organi fitues nuk kishte përmbushur kriteret. Edhe në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me datë 13.05.2019, pran të cilave ka pohuar se qëndron në tërësi, ka deklaruar ngjashëm për rrethanat për të cilat është pyetur.

Gjykata vlerëson dëshmitë e dëshmitarit A.K të cilët dëshmi e ka gjetur si të sinqertë dhe objektive, e cila dëshmi është në përputhje me dëshmitë e dëshmitarëve tjerë dhe provat materiale, e nga cila vërtetohet bindshëm fakti se tani i akuzuar R.B në cilësinë e kryetari të Komunës, ka nxjerr vendimin me datë 26.10.2018, dhe datë 29.10.2018, me numër 01/1559, duke anashkaluar Kuvendi i Komunës të ....., si organ i vetëm kompetent për të vendosur për bartjen e mjeteve financiare nga një kod ekonomik në kod tjetër, dhe se asnjëherë nuk është kërkuar të vendos lidhur me këtë çështje. Po ashtu nga dëshmi e këtij dëshmitari vërtetohet bindshëm fakti se përkundër ekzistimit të vendimit të datës 04.05.2018, me numër 02/135 të nxjerr nga Kuvendi Komunal i ....., që ka të bëjë me ndërtimin e sallës sportive në shkollën e mesme e ulët “.....”, në fshatin ....., ky vendim nuk është zbatuar nga kryetari i Komunës tani i akuzuari R.B, ndërsa që po ashtu është vërtetuar bindshëm fakti se lidhur me ndërtimin e shkollës fillore në fshatin ....., nuk ka pasur asnjë kërkesë nga kryetari tani i akuzuari R.B për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e kësaj shkolle, mirëpo që më vonë pas fillimit të ndërtimit të shkollës çështja është sjell në Kuvend Komunal për ndërrimin e destinimit, ku nuk ka pas të bëjë me caktim e lokacionit por me këmbimin e pronës nga prona private në pronë publike, cka vërteton faktin se tani i akuzuari R.B, ka qenë në dijeni për detyrimin ligjor që lidhur me këtë procedurë duhet të vendos Kuvendi Komunal, se nuk ka autorizime ligjore që të kryej veprime para se Kuvendi Komunal të vendos lidhur me shpronësimin apo këmbimin e pronës, pra edhe nga ky dëshmitar, vërtetohet fakti se i akuzuari R.B, edhe nuk i ka përmbushur detyrimet e tij ligjore duke refuzuar të zbatoj një vendim të Kuvendit Komunal, mirëpo edhe ka uzurpuar autorizime ligjore të një organi tjetër duke hyrë në marrëveshje me pronarin e tokës, për ndërtimin e shkollës fillore në fshatin ....., apo duke bërë bartjen e mjeteve financiare nga një kod ekonomik në kod tjetër buxhetor.

**Dëshmitari RR.M** në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 03.02.2022, ka deklaruar se ka qenë kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e ....., dhe në këtë cilësi në koordinim me kryetarin e Komunës, ka kryesuar Kuvendin Komunal, ka bërë rendin e ditës, e që duke u bazuar në këto rrethana, ka njohuri për vendimin e Kuvendit Komunal të ..... të

datës 04.05.2018, lidhur me ndërtimin e sallës së sporteve ne shkollën fillore të mesme “.....” në fshatin ....., Komuna e ....., vendim i cili nuk është zbatuar, ndërsa që kërkesa ka qenë e kryetarit që salla të ndërtohet në shkollën “.....” në fshatin ....., prandaj nuk është zbatuar vendimi i kuvendit nga ana e kryetarit, anipse ka qenë detyrim i tij, zbatim i këtij vendimi, ekzekutivi ka nxjerrë edhe një vendim që nuk ka të drejtë, ka vepruar në mënyrë kundërligjore, ka nda lokacion në oborrin e shkollës “.....”, për me ndërtua sallës e sportit, edhe pse ekzekutivi nuk ka drejtë me nda lokacion, por kuvendi ka kompetenca me nda lokacion, dhe me këtë rast, nuk është realizuar shuma e ndarë nga Ministria për rini kulturë dhe sport, afërsisht 300.000 euro. Më tutje sa i përket ndërtimit të shkollës fillore në fshatin ..... Komuna e ....., vendimi për ndërtim është dashur të merret nga kuvendin komunal, e që s’ka ndodh, është dashtë të ndahen mjetet për projekt, nuk kanë ndodhë, është vendos gur themeli i shkollës, pa u nda lokacioni, anipse fillimisht është dashur të bëhet këmbimi i pronës, pasi që një pjesë e shkollës është ndërtuar në pronën private pa u bërë këmbimi paraprak i pronave, fillimisht është ndërtuar shkolla, pastaj është bërë kërkesë nga kryetari të bëhet këmbimi i pronës pranë kuvendit komunal, kërkesë që është përsëritur 3-4 herë për të hyrë në rend ditë, por anëtarët e Kuvendit e kanë refuzuar sepse lënda ka qenë në gjykatë, dhe kur është lënda në gjykatë, kuvendi nuk mirr me atë çështje. Më tutje ka shtuar se lidhur me vendimin e kryetarit të komunës me datë 26.10.2018, për lëvizjen e mjeteve buxhetore nga një projekt në projektin tjetër për disa projekte të komunës së ....., ky vendim është dashtë të kaloj përmes kuvendit, kryetari është dashtë ta bën bartjen e mjeteve përmes kuvendit. Edhe në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në polici me datë 23.05.2019, ngjashëm ka deklaruar për rrethanat për të cilat është pyetur.

**Dëshmitari A.M**, në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës 15.02.2022, ka deklaruar se prej viti 2017, është në cilësinë e këshilltarit komunal nga radhët e PDK-së, dhe se është në detyrimin e kryetarit të komunës që të raportoj para asamblesë komunale, me raport financiar çdo 3 muaj 6 muaj 9 muaj dhe 1 vjeçar, dhe se i kësaj natyre ka qenë edhe raporti i viti 2018, në të cilin raport ju është raportuar për shtrimin e disa rrugëve me asfalt, mirëpo në terren nuk qenë të përfunduara ndërsa në raport kanë qenë të shkruara si të përfunduara, e që një nga këto projekte ka qenë edhe shtrimi i rrugës nga ura kryesore në drejtim të urës së mini tranzitit, dhe rruga që lidhet prej xhamisë deri të varrezat e dëshmorëve, dhe një rrugë tjetër ka qenë e raportuar nga lagjja Veselaj në drejtim të fshatit Banjë, këto kanë qenë të raportuara në raportin financiar të investimeve kapitale, ndërsa në terren nuk kanë qenë të përfunduara. Më tutje ka shtuar se është në djeni për vendimin e kryetarit të kuvendit të ....., të datës 26.10.2018, lidhur me lëvizjen e projekteve dhe pagesave të tyre nga një projekt në projektin tjetër, mirëpo që ky vendim nuk është konstatuar në raportin financiarë që i është dorëzuar atyre, edhe pse gojarisht, kanë kërkuar sqarime lidhur me atë vendim, mirëpo që këto sqarime nuk i janë dhënë asnjëherë. Ka theksuar se nuk ka dijeni lidhur me projektin rregullimi dhe mirëmbajtja e palestrës të stadiumit futbollit me nr 7644 e cila ka qenë në vlerë prej 59,769.98 euro, mirëpo që ka dijeni lidhur me ndarjen e një parcele për ndërtimin e sallës së sporteve në shkollën e mesme të ulët emri “.....” në fshatin ....., vendim i marrur nga kuvendi komunal i ....., mirëpo që vendi i ndarë nuk ka qenë jo aty ku ka pas propozua qeveria komunale e asaj kohe, përkatësisht propozimi i qeverisjes komunale ka qenë që të ndërtohet afër shkollës së mesme të ulët “.....” dhe se kjo ka qenë edhe arsyeja pse ai vendim nuk është zbatuar asnjëherë. Po ashtu ka shtuar se ndërtimi i objektit shkollës fillore në fshatin Panoc është bërë pa i respektua procedurat ligjore, asambleja nuk ka marr vendim që ajo zonë të shpallet zonë me interesit ë veçantë, dyshimet janë se një pjesë e shkollës është ndërtua në pronë private, dhe është kërkuar ndërrim destinimi i pronës pasi ka fillua ndërtimi objektit, gjë nuk kanë pranuar që kjo kërkesë të futet në rend të ditës në Asamblenë Komunale. Ka theksuar se qëndron në tërësi pranë deklaratës të dhënë në Polici me datë 03.05.2019, ku ka deklaruar njëjta si dhe në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit RR.M dhe A.M, të cilët dëshmi e ka gjetur si dëshmi të sinqertë dhe objektive, nga e cila ka vërtetuar pakontestueshëm faktin se i akuzuari R.B, nuk e ka zbatuar vendimin nr.01/1527, e datës 23.10.2018, e Kuvendit Komunal lidhur me ndërtimin e sallës së sporteve ne shkollën fillore të mesme “.....” në fshatin ....., Komuna e ....., edhe pse ka qenë i obliguar ta zbatoj, për me tepër ka nxjerrë edhe një vendim për ndërtimin në oborrin e shkollës “.....” që nuk ka pasur të drejtë të nxjerr një vendim të tillë, pas që kjo është kompetencë vetëm e Kuvendit Komunal, dhe se pikërisht ky vendim i të akuzuarit R.B, ka rezultuar me humbjen e fondeve të dakorduara nga Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit, dhe salla sportive nuk është ndërtuar asnjëherë. Po ashtu nga dëshmia e këtyre dëshmitarëve është vërtetuar fakti se ndërtimi i objektit shkollës fillore në fshatin Panoc është bërë pa i respektua procedurat ligjore, pasi që Kuvendi Komunal nuk kishte vendosur asnjëherë lidhur me këtë çështje, përkatësisht se kërkesa që Kuvendi Komunal të vendos për shpallje të pronës private në zonë me interes publik, ishte dorëzuar në Kuvend, vetë pasi që ish-in kryer të gjitha procedurat tenderimit dhe ishte nënshkruar kontrata për ndërtim, dhe pasi që veprimet e tani të akuzuarit R.B ish-in denoncuar tek organet kompetente të ndjekjes.

**Dëshmitari V.M,** në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës 15.02.2022, ka deklaruar se ka qenë drejtor për financa prej 05.02.2018 deri në fund vit 2018, e edhe gjatë viteve pasuese, dhe se sikurse çdo vit tjetër edhe raporti për vitin 2018, që ka pasqyruar të hyrat dhe shpenzimet i është adresuar Kuvendit Komunal, dhe se këto raporte nuk kërkojnë miratimin e kuvendit, vetëm njoftohen-pasqyrohet për anëtarët e kuvendit. Më tutje ka shtuar se vendimi i datës 26.10.2018, i nxjerrë nga ana e Kryetari i Komunës të ..... lidhur me lëvizjen e mjeteve financiare për pagesa nga një program në programin tjetër ose nga një projekt në projektin tjetër, është nxjerr në interes të Komunës me qëllim që ato mjete të cilat nuk kanë mundur të ekzekutohen për arsye të ndryshme janë destinuar për mi pagua disa obligime brenda kontratave që kanë qenë në atë vit fiskal, ndërsa që nuk e dinë që vendimet e kryetarit duhet mu miratua në Kuvend, për me tepër që konsideron se përmes këtij vendimi është mbrojt paraja publike duke pas parasysh që momentin që nuk paguhen obligimet e komunës me kohë, obligimet marrin kosto shtesë përmes procedurave përmbarimore, ndërsa që si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore nga sektori arsimit për shujta për paga jubilarë, paga përcjellëse, shumë projekte janë dëmtua pasi që thesari i Kosovës i ka ekzekutua këto mjete për pagat për mësimdhënës nga projektet kapitale për përfituesit – mësimdhënësit, duke mos e njoftuar Komunën për mjetet që janë marrë nga buxheti i Komunës për mi ekzekutua vendimet gjyqësore të formës së prerë. Ka shtuar se sa i përket vendimin e dt. 04.05.2018 me nr.02/135 të Kuvendi Komunal me qëllim për ndërtimin e sallës në fshatin ....., sa ka njohuri është kërkuar përcaktimi i lokacionit nga ministria përkatëse dhe ajo pastaj ka kalua në fshatin ....., qëllimi ka qenë të ndërtohet te shkolla “.....” sepse shkolla është më e madhe ka numër më të madh të nxënësve, për arsye se në atë fshat janë 3 shkolla, dhe qëllimi ka qenë të jetë në qendër të fshatit në shkollën më të madhe në mënyrë që të jetë e qasshme në mënyrë të barabartë nga i gjithë komuniteti, dhe për disa fshatra më të vogla afër fshatit ..... siç është fshati Vermicë, ndërsa që nuk ka njohuri se çka ka ndodh me tute. Po ashtu sa i përket shkollës në fshatin .....-Komuna ....., është ndërtuar me kërkesë të banorëve që të kenë kushte më të mira me zhvillua fëmijët e tyre mësimin, duke plotësua nevojat çoftë për mësim teorik apo praktike, dhe si rrjedhojë është paraqit kërkesa dhe nevoja të ndërtohet ajo shkollë e cila tani më është e ndërtuar dhe të gjithë banorët e atij fshati kanë qenë të kënaqur dhe falënderues për kryetarin Begaj për kushtet e krijuara, dhe sa ka njohuri e njëjta shkollë nuk është ende funksionale sepse duhet bërë pajisja me inventarë shkollorë, ndërsa që nuk ka njohuri në çfarë prone është ndërtuar. Në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me datë07.08.2018, përmbajtja e të cilës ka deklaruar se nuk i kujtohet, ka elaboruar procedurën e

planifikimit dhe miratimit të buxhetit komunal, pastaj procedurën për ndryshimin e tij, e cila bëhet përmes Asamblesë Komonale, dhe se në këtë drejtim vendimi i datës 26.10.2018, i protokolluar me datë 20.10.2018, me nr.01.2559 i nxjerr nga tani i akuzuari R.B, është dashur të miratohet nga Kuvendi Komunal, mirëpo nuk është aprovuar. Ka shtuar se raporti i vitit 2018, si dhe çdo raport tjetër përpilohet mbi bazën e transaksioneve të regjistruara në librat e thesarit, dhe si i tillë nuk pasqyron përfundimin e punimeve, ndërsa që në vijim, ka shpjeguar realizimin e projekteve e veçanta duke sqaruar se ose janë realizuar në vitin vijues ose mjetet janë përdorur në projekte tjera ose ka ekzistuar ndonjë pengesë tjetër, qe ka pamundësuar realizimin e tyre.

**Dëshmitari M.M** në dëshminë e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 10.03.2022 ka deklaruar se që nga viti 2003 punon në Kuvendin Komunal të ....., nga viti 2017 mban pozitën udhëheqës i shërbimit të Kuvendit Komunal, ndërsa që ka punuar edhe si këshilltar ligjor në zyrën e Kryetarit R.B. Ka shtuar se vendimin për ndërtimin e shkollës në fshatin ....., e ka marrë Kuvendi i Komunës duke ndarë edhe buxhetin për atë shkollë, dhe në momentin e ekzekutimit të projektit është parë që nuk e ka pasur hapësirën e mjaftueshme për shkollë, pastaj Kryetari bashkë me stafin profesional dhe në bashkëpunim me kryesuesin RR.M, është biseduar se duhet të nisët procedura e këmbimit të pronës publike me atë private për ti lejuar hapësirë të mjaftueshme ndërtimit të objektit të ri, dhe nga kryesuesi është kërkuar që të ipet edhe pëlqimi i palës në këtë rast, është fjala për pronarin faktik të pronës, B.R pasi që pronari juridik ka qenë vëllau i tij, përçka edhe në zyrën në të cilën kanë qenë prezent dëshmitari, kryesuesi, kryetari dhe pala, në parim është dhënë pëlqimi për fillimin e procedurës, pastaj është bërë kompletimi i të gjitha dokumentacionit të nevojshëm është bërë 13 herë kërkesë në Kuvend për fillimin e procedurës se këmbimit të pronës publike me pronë private, mirëpo Kuvendi nuk ka lejuar me fut në rend të ditës për arsye politike, për shkak se Kryetari nuk e ka pas shumicën e anëtarëve të partisë së tij në Kuvend për ti siguruar votat e mjaftueshme. Lidhur me këtë rast ka shtuar se në këtë rast është ruajtur interesi publik meqenëse nuk është dëmtuar objektit ekzistues të shkollës, fusha e shkollës, është evituar kosto e dyfishtë e projektit për shkak të terrenit të pa përshtatshëm, e po ashtu nuk është bllokuar pala për shfrytëzimin e pronës se tij për shkak se po të ndërtohej shkolla vetëm në pronën publike, palës në këtë rast B.R do ti bllokohet qasja në pronën e tij, dhe se edhe qytetari B.R, i cili e kërkon këmbimin pronës, do të i bëhet këmbimi në bazë të ligjit, dhe vlerësimit të Ministrisë së Financave, pasi që pala nuk ka pajtuar që të merr mjete financiare në emër të kompensimit për eksproprijim, ndërsa që në Komunën e ..... janë me tepër se 5 shkolla në pronë private, nuk ka pas ankesë, ka pas pajtueshmëri dhe qeto parime kane qenë që janë udhëheq. Më tutje ka shtuar se sa i përket ndërtimit të sallës së sporteve në fshatin ....., që nga fillimi ka pasur mos pajtime për ndërtimin e asaj sallë në fshatin ..... për arsyeje se brenda kryesisë se fshatit disa kanë qenë pro dhe disa kundër për çështjen e lokacionit, e kjo ka qenë rrjedhojë se janë keq informuar që palestra e sporteve do të ndërtohet afër shkollës fillore “.....”, më pastaj kryesia e fshatit ka kuptuar se kërkesa e Ministrisë dhe e Komunës nuk është që të ndërtohet salla e sporteve afër shkollës fillore “.....”, dhe pastaj kanë ndërruar qëndrim dhe kanë vendosur që të ndërtohet afër shkollës fillore “.....” në fshatin Llashka ..... Ka theksuar se vendimet e Kuvendit Komunal janë të obligueshme për zbatim vetëm pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Pushtetit Lokal, dhe pas publikimit të tyre në web faqen e Komunës, jo të gjitha vendimet e Kuvendit janë të obligueshme për shkak se shumë prej tyre Ministrit gjegjëse kërkojnë që të shfuqizohen.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshmimit e këtyre dy dëshmitarëve V.M dhe M.M, të cilat dëshmi e ka gjetur si të pasinqertë dhe jo objektive, e përpunuar dhe në funksion të lehtësimit të përgjegjesisë penale të tani të akuzuarit R.B, pasi që të gjitha vendimet dhe veprimet e kundërligjshme të nxjerra apo të bëra nga i njëjti, i kanë shpjeguar me ekzistimin e interesit publik, në funksion të cilit kinse ka vepruar tani i akuzuari R.B, mirëpo që si duke ky dëshmitar

i harron se respektimi ligjit dhe procedurave ligjore është interesi me i lartë publik, i cili duhet të mbizotëroj para të gjitha interesave tjera, të çfarëdo natyre qofshin, e aq më shumë në rastin konkretë, kur siç është vërtetuar bindshëm, se ska pasur kërkesë të paraqitur në Kuvendin Komunal për kalimin e mjeteve financiare nga një kod buxhetor në tjetrin, apo vendim lidhur me ndërtimin e shkollës fillore në fshatin ....., qoft lidhur me shpronësim a po këmbim të tokës, siç është rregulluar shprehimisht me ligj.

### **Provat materiale**

Nga Planifikimi përfundimtar i prokurimit për vitin 2018, i Komunën e ....., i datë 01.02.2018, vërtetohet se në të njëjtën është bërë përshkrimi përmbledhës i kontratave të planifikuara për vitin fiskal 2018, që si i tillë është ndarë në Kontrata për furnizim, kontrata për shërbime, kontrata për punë, dhe konkurset e projektimit.

Nga Kërkesa Nr.01/211, i datës 12.02.2018, shqyrtim dhe marrje të vendimit për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sporteve në fshatin ....., Komuna e ....., paraqitur nga kryetari i komunës së ....., tani akuzuari R.B, vërtetohet se përmes të njëjtës është kërkuar që të ndahet lokacioni për ndërtimin e Sallës së Sporteve, në pjesën e ngastrës kadastrale nr.P-7231-0009-01476-0 në vendin e quajtur “Halishta-shkollë, pronë publikë, në emër të shkollës fillore “.....” në ....., në sipërfaqe prej 6918m2.

Nga Vendimi i Kuvendit Komunal nr.02/134, i datës 04.05.2018, vërtetohet Kuvendi Komunal i ..... në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2018, ka refuzuar kërkesa Nr.01/211, e Kryetarit të Komunës së ..... për marrjen e vendimit për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve në SHFMU “.....” në fshatin .....

Nga Vendim Nr.02/135, i datës 04.05.2018, për caktimin e vendit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin ....., i nxjerr nga Kuvendi Komunal i ..... në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2018, ka vendosur që salla e sportit në fshatin Drenco të bëhet në oborrin e SHFMU “.....”, ndërsa që ndërtimi të realizohet sipas projektit të Ministrisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit. Caktimi i lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve propozohet në Zonën Kadastrale Llashka....., ngastra kadastrale nr.P-723100009-02734-0, në vendin e quajtur Rrafshi-Grellë, në sipërfaqen e përgjithshme 9821m2, pronë publike e Kuvendit Komunal në ..... Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen, Kryetari i komunës, përmes drejtorive të Arsimit, Urbanizimit, gjeodezi, Kadaster dhe shërbime Pronësore-Juridike.

Nga Kërkesë Nr.02/171, e datës 29.05.2018, e paraqitur Kryetari i Komunës R.B, për Kuvendin e Komunës së ....., vërtetohet se përmes të njëjtës është kërkuar që të shqyrtohet vendimi Nr.02/135, i datës 04.05.2018, për ndërtimin e sallës sportive në fshatin ....., pasi që një vendim i tillë është në kundërshtim me kërkesën e kryetarit të Komunës nr.01/211, i datës 12.02.2018, i cili ka propozuar që salla sportive të ndërtohet në SHFMU “.....” në fshatin .....

Nga aktvendimi nr.01/1527, i datës 23.10.2018, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin ..... i nxjerr nga kryetari i Komunës R.B, vërtetohet se lokacioni për ndërtimin e e Sallës së Sporteve në ....., është ndarë, në pjesën e ngastrës kadastrale nr.P-7231-0009-01476-0, në vendin e quajtur “Halishta-shkollë, pronë publikë, në emër të shkollës fillore “.....” në ....., në sipërfaqe prej 6918m2.

Nga kërkesa për përgatitjen e dokumentacionit lidhur me projektin kapital “Salla e sportit në ..... të .....” nr. 261/2018, e datës 30.01.2018, e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për kryetarin e komunës së ..... tani të akuzuarin R.B, vërtetohet se përmes të njëjtës është kërkuar plotësimi i dokumentacionit si në vijim: vendimi i asamblesë komunale për ndarjen

e parcelës; kopja e planit; fleta poseduese; shpimet gjeo-mekanike të vendit ku ndërtohet objekti; projekti kryesore dhe para-masat me para-llogari.

Gjykata ka vlerësuar edhe Kërkesa Nr.01/211, i datës 12.02.2018, shqyrtim dhe marrje të vendimit për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sporteve në fshatin ..... K.K .....; Vendimi i Kuvendit Komunal nr.02/134, i datës 04.05.2018; Vendim Nr.02/135, e datës 04.05.2018, për caktimin e vendit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin .....; Kërkesë Nr.02/171, të datës 29.05.2018, e paraqitur Kryetari i Komunës R.B, për Kuvendin e Komunës së .....; kërkesa për përgatitjen e dokumentacionit lidhur me projektin kapital “Salla e sportit në ..... të .....” nr. 261/2018, e datës 30.01.2018, dhe aktvendimi nr.01/1527, i datës 23.10.2018, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin ....., të gjitha këto të administruara në cilësinë e provave materiale, e nga të cilat ka vërtetuar bindshëm faktin se tani i akuzuari R.B, në Kuvendin komunal kishte paraqitur kërkesë që të ndahet lokacioni për ndërtimin e Sallës së Sporteve, në oborrin e shkollës fillore “.....”, në ....., në sipërfaqe prej 6918m<sup>2</sup>, ndërsa që nga Kuvendi Komunal ishte nxjerr vendim qe e njëjte të ndërtohet në fshatin ..... të bëhet në oborrin e SHFMU “.....”, sipas projektit të Ministrisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit, për çka i akuzuari R.B nuk është pajtuar dhe ka kërkuar shqyrtimin e këtij vendimi, i cili si i tillë ka mbetur në fuqi, mirëpo që përkundër kësaj të njëjtin nuk e ka zbatuar, meqenëse nuk është vendosur sipas kërkesës së tij, për më tepër në tejkallim të autorizimeve të tij ligjore ka vendosur që salla e sportit të ndërtohet në oborrin e shkollës fillore “.....”, e që pikërisht mos zbatimi i këtij vendimi të Kuvendit Komunal, ka rezultuar me mos ndërtimin e kësaj salle të sporteve, për ndërtimin e të cilës ishte dakorduar një fond i veçantë nga Ministrisë e Kulturës, Rinis dhe Sportit.

Nga Procesverbali i shkruar me dorë nga kryesia e fshatit ....., për caktimin e vendit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin ....., vërtetohet se nga kryesia e këtij fshati është vendosur që salla e sporteve të ndërtohet në qendër të fshatit ....., në oborrin e shkollës “.....”. Në procesverbal janë nënshkruar 8 persona, në cilësinë e kryesisë së këtij fshati, duke u evidentuar me nr.personal dhe nënshkrim.

Nga shkresa-Informim për lëvizjen e nxënësve nga SHFMU (shkolla fillore e mesme e ulët) “.....”, e datës 15.05.2019 nga Drejtorja e Arsimit në Komunën e ....., për kryetarin e komunës, vërtetohet se në të njëjtën është konstatuar se nga shkolla SHFMU “.....”, janë themeluar edhe dy shkolla tjera, SHFMU “.....” dhe SHFMU “ ”, dhe poashtu është paraqitur lëvizja ne vite e nxënësve në këto dy shkolla, përkatësisht këto dy shkolla në vitin 2015/16 kanë pasur 609 nxënës; në vitin 2016/17 kanë pasur 574 nxënës, ndërsa që në vitin 2017/18 kanë pasur 546 nxënës.

Nga Raporti Nr.07/2018, datë 07.02.2018, për caktimin e vendit të ndërtimit të sallës së sporteve i përpiluar nga D.M - drejtor në SHFMU“.....”, në ....., për Kryetarin e Komunës R.B, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se pas mbledhjes së këshillit të arsimitarëve, është vendosur që vendi me i përshtatshëm për ndërtimin e sallës së sporteve, është mbrapa shkollës, përkatësisht në pjesën veri-perëndimore të shkollës, vend në oborr të shkollës, kryesore është që të Salla e sportit të jetë ngjitur për shkollë.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat materiale Procesverbali i shkruar me dorë nga kryesia e fshatit ....., shkresa-Informim për lëvizjen e nxënësve nga SHFMU “.....” e datës 15.05.2019 nga Drejtorja e Arsimit në Komunën e ..... dhe Raporti Nr.07/2018, datë 07.02.2018 për caktimin e vendit të ndërtimit të sallës së sporteve i përpiluar nga D.M -drejtor në SHFMU “.....”, në ....., mirëpo të njëjtat nuk i gjeti relevante në vërtetimin e ndonjë fakti të rëndësishme në këtë çështje penale,

Nga Kërkesë e Kuvendit Komunal në ....., drejtuar Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, për përdorim të autoritetit, nr.2, e datës 15.11.2018, vërtetohet se me të njëjtën është kërkuar që kjo Ministri të përdor autoritetin dhe autorizimet ligjore që vendimi i Kuvendit Komunal të ..... të zbatohet, vendim të cilin është vendosur për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin ....., në oborrin e shkollës “.....”.

Nga Përgjigja Nr.020-1374, e datës 06.12.2018, e Qeveris së Kosovës-Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me kërkesën për interpretim të vendimit nr.135 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin ....., i miratuar me datë 30.04.2018 nga Kuvendi Komunal, vërtetohet se në të njëjtën është konstatuar që ky vendim është në përputhje me mandatin e Kuvendit Komunal si organi më i lartë vendimmarrës në Komunë. Komuna e ..... është e obliguar ta zbatoj këtë vendim të Kuvendit Komunal, në tërësinë e tij.

Gjykata ka vlerësuar kërkesë e Kuvendit Komunal në ....., drejtuar Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, për përdorim të autoritetit, nr.2, e datës 15.11.2018 dhe Përgjigjen Nr.020-1374, e datës 06.12.2018, e Qeveris së Kosovës-Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e nga të cilat ka vërtetuar bindshme faktin se në përgjigje të kërkesës së Kuvendit Komunal, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përgjigjen e dhënë ka konstatuar se vendimi i Kuvendit Komunal nr.135 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin ....., është nxjerr në përputhje me mandatin e këtij organi dhe është në detyrimin e Komunës që ta zbatoj të njëjtin. Përmes përgjigjes së dhënë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe duke pasur parasysh kohën kur është dhënë kjo përgjigje, vërtetohet se tani i akuzuari R.B, ka qenë në dijeni për detyrimin e tij ligjor, për zbatimin e vendimit të Kuvendit Komunal.

Nga Vendim Nr.01/261, i datës 21.02.2018, e Kryetarit të Komunës së ....., R.B, vërtetohet se është autorizuar B.K zyrtar i prokurimi, që të ushtoj të gjitha detyrat dhe obligimet që lidhen me menaxhimi e Prokurimit në ....., prej datës 21.02.2018, deri në përzgjedhjen e Menaxherit të prokurimit përmes procedurave të rekrutimit.

Gjykata ka vlerësuar edhe këtë vendim të administruar në cilësinë e provës materiale, e nga e cila ka vërtetuar faktin se tani i akuzuari R.B, ka autorizuar zyrtarin e prokurimi B.K, që të kryej të gjitha detyrat dhe obligimet që lidhen me menaxhimi e Prokurimit, e që pikërisht në këtë cilësi i njëjti edhe ka nënshkruar kontratën Nr.03/123, të datës 30.08.2019, me nr. identifikues 62500.18.141.511, me operatorin ekonomik “ ..... ” me çmim total prej 495,860.60€, përkatësisht është nënshkruar në emër të N.SH i cili rezulton si menaxher i prokurimit, e që nga pamja e të njëjtës është vështirë e kuptueshme se kush e ka nënshkruar këtë kontratë pas që para emrit është vendosur para fjala “për”, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 26 të LPP-së, ku është përcaktuar detyrimi ligjor që çdo kontratë publike e cila të nënshkruhet nga Menaxheri i Prokurimit apo Zyrtari Kryesor Administrativ, në rastet kur kemi të bëjmë me kontratë me vlerë të madhe, ndërsa që në rastin konkret, Komuna e ..... ka hyrë në detyrime kontraktuale, në vlerën e referuar më lartë, përderisa në bazë të kontratës thuajse është e pamundshme me kuptuar se kush është nënshkruar në cilësinë e përfaqësuesit të organit kontraktues, e kjo e gjitha si rrjedhojë e veprimit të tani të akuzuarit R.B, i cili ka marr vendim që B.K, të i kryej të gjitha detyrat dhe obligimet që lidhen me menaxhimi e Prokurimit, e duke abstenuar nga autorizimet e tij ligjore në cilësinë e zyrtarit kryesor administrative, ndërsa që në anën tjetër duke tejkuluar autorizimet e tij ligjore për zhvillimin procedurave të prokurimit në mungesë të një vendim të Kuvendit komunal lidhur me ndarjen e lokacionit për ndërtimin e shkollës, përkatësisht kompensimin financiar apo këmbimin e tokës me pronarin e parcelës ku është kontraktuar ndërtimi i një pjese të objektit shkollor.



Nga Aktvendimi Nr.01-1559, i datës 29.10.2018, i nxjerr nga kryetari i Komunës R.B, vërtetohet se përmes të njëjtës është bërë lejimi i lëvizjes se projekteve dhe pagesa e tyre nga program në program, nga projekti në projekt nga data 26.10.2018 deri me datë 31.12.2018, ky vendim është marr për shkak të mos realizimit të rishikimit të buxhetit në kohë, si dhe për shkak se disa projekte kanë pasur mungesa në zbatimin me kohë ndërsa disa të tjera janë realizuar me më pak mjete financiare.

Nga Njoftim i datës 24.05.2018, mbi ecurinë e punimeve për projektin “punimi i kanalizimit nëpër fshatrat e komunës së ....., Menaxheri i projektit , ka konstatuar që gjatë realizimit të këtij projekti ka pasur pengesa për shkak të konfiguracionit jo të mirë në teren dhe kushteve jo të mira atmosferike, ashtu që punimet kanë mbetur të papërfunduara.

Nga Përgjigje Nr.Prot.104, të datës 25.07.2018, e Ministrisë së Financave, vërtetohet se duke vepruar sipas kërkesës së datës 24.07.2019, të paraqitur nga Policia e Kosovës, janë siguruar të dhënat lidhur me projektet si në vijim: proj.kod 42006-Kanalizimi në lagjen e re; proj.kod.42007-kanalizimi në lagjen “ .....” në .....; proj.kod 46723-ndërtimi i rrugëve periferike-minitransiti në qytezën e .....; proj.kod 46723-rregullimi i shtratit të lumit Mirusha nga ura e madhe në drejtim të minitransitit (trotuar, rrugë); proj.kod 40993-Sh.Fillore “ .....”-aneks; proj.kod 46744-Rregullimi dhe mirëmbajtja së palestrës së sporteve dhe stadiumit të futbollit; proj.kod 46793-ndërtimi i fushës së sportit Berishë, Burim, Shkozë, të gjitha në Komunën e ....., për vitin fiskal 2018.

Nga Njoftim Nr.03/123,të datës 26.10.2018, për shpenzimet e buxhetit janar-shtator 2018, nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për kryetarin e komunës R.B, vërtetohet se në të njëjtën është konstatuar se buxheti i tërësishme i komunës është shfrytëzuar në masën prej 66.74%, kurse vetëm për projekte kapitale shpenzimet kanë qenë në masën 50%. Duke u nisur nga ky fakt, konstatohet se përqindja e shpenzimet të buxhetit nuk është e kënaqshëm, ndërsa që obligimet e papaguara në disa programe dhe projekte tjera e rrisin listën e tërësishme të obligimeve. Prandaj të lejohen pagesat nga projekti në projekt, nga programi në program dhe nga ka njëra kategori ekonomike në tjetrën.

Gjykata ka vlerësuar edhe Aktvendimin Nr.01-1559, i datës 29.10.2018, Njoftimin e datës 24.05.2018, Përgjigjen Nr.Prot.104, të datës 25.07.2018 dhe Njoftimin Nr.03/123,të datës 26.10.2018, të gjitha këto të administruara në cilësinë e provës materiale, e nga të cilat ka vërtetuar faktin se i akuzuari R.B, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi ka marr vendim për lejimi i lëvizjes se projekteve dhe pagesës së tyre nga program në program, ani pse kjo ka qenë kompetencë e Kuvendit Komunal si i vetëm organ i autorizuar për të lejuar lëvizje të tilla, dhe pastaj siç vërtetohet nga raporti i ekspertizës financiare të datës 17.11.2020, këto mjete financiare të këtyre projekteve janë shpenzuar për qëllime tjera, siç është rasti me projektin me titull “Mirëmbajtja dhe rregullimi i palestrave sportive dhe stadiumeve” me PIP projekt 46744, ku në emër të këtij projekti është bërë një shpenzim prej 59,769.98 dhe një pjesë e kësaj shume është bërë për shpenzime tjera që i takojnë kategorisë së shpenzimeve mallra dhe shërbime, apo lidhur me projektin me nr. 40993 me titull “Ndërtimi i aneksit të shkollës ‘ .....’”, ku për këtë projekt në vitin 2018 janë paraparë mjete në vlere prej 170,000.00 Euro në buxhetin e vitit 2018 por të gjitha këto mjete janë paguar për avokat, pagesa për persona fizik siç është pagesa për furnitorin me ID e furnitorit 4065336, ku nga PIP projekti i janë paguar 13,000.00 Euro, pastaj nga ky projekt janë paguar shpenzime reprezentacioni ndërsa në raportin financiar prezantohen si investime kapitale, kurse pagesat në shumë prej 169,586.29 janë bërë krejtësisht për shpenzime tjera. Pra nga të gjitha këto prova vërtetohet pakontestueshëm fakti se si rrjedhojë e veprimit të kundërligjshme të tani të akuzuarit R.B, mjetet financiare të dedikuara për projekte të caktuar në buxhetin vjetor të miratuar nga Kuvendi Komunal si organi i vetëm që ka

kompetencë për hartimin apo ndryshimin e tij, është mundësuar që të njëjta të përdoren për shpenzime tjera, të parapara me kode tjera buxhetore.

Nga Aktvendimi për iniciimin e procedurave të prokurimit, Nr.01/1097, të datës 24.07.2018, i nxjerr nga Kryetari R.B, vërtetohet se është vendosur lejimi i mjeteve financiare në shumë prej 678,119.42 euro, në emër të realizimit të projektit për ndërtimin e objektit të ri shkollor në fshatin ....., e të cilat mjete lejohen sipas para masës dhe para llogarisë të përgatitur nga shërbimet profesionale të Drejtorisë së Urbanizmit.

Nga deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmëris së fondeve të datës 09.08.2018, vërtetohet se lënda e kontratës është “ndërtimi i objektit të shkollës më fshatin ....., me vlerë të parashikuar 678.119,42 euro. Deklarata për disponueshmërin e fondeve, është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit N.SH, zyrtar kryesor financiar H.SH, zyrtari kryesor administrativ “për” R.B.

Nga Kontratë prokurimi Nr.79, me shenjen Nr.03/123 e datës 26.10.2018, vërtetohet se e njëjta është lidhur në mes Komunës së ..... si autoritete kontraktues dhe Konzorcimi i OE NT “.....”, me seli në ....., në cilësinë punë marrësit, për “Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në fshatin ....., me çmim total prej 495,860.60 euro. Për autoritetin kontraktues është nënshkruar për N.SH, ndërsa që për operatorin ekonomik është nënshkruar I.B në cilësinë e drejtorit.

Nga Kërkesë Nr.01-1597, të datës 06.11.2018 për marrjen e vendimit për ndërrimin e pronës publike në pronë private, e paraqitur nga Kryetari i Komunës së ..... R.B, drejtuar Kuvendit Komunal, vërtetohet se me të njëjtën është kërkuar që të shpallet zonë me interes të veçantë sipërfaqja prej 836m2 në pjesën e ngastrës kadastrale nr.P-72310064-00705-0, në vendin e quajtur ....., me kulturë livadh i klasit 6, pronë private në emër të R.S nga fshati ....., ZK-.....ë. Kërkesa është paraqitur duke u bazuar në interesin publik për ndërtimin e shkollës së re.

Nga Raporti i punimeve për projektin “Shkolla fillore në ....., i datës 15.05.2018 (2019), i përpiluar nga Menaxheri i projektit J.K, vërtetohet se në të njëjtën janë evidentuar vlera e punimeve të realizuara, vlera e paguar për punimet e kryera, si dhe fakti që punimet janë në zhvillim e sipër dhe se deri në momentin e pikërisht janë kryer rreth 50% e punimeve.

Nga Kopje e planit të parcelës për ndërtimin e shkollës në ....., i datës 23.05.2018, Agjencia Kadastrale, vërtetohet se pjesa në të cilën është parashikuar ndërtimi i shkollës më sipërfaqe prej S-836m2.

Gjykata ka vlerësuar edhe Aktvendimin për iniciimin e procedurave të prokurimit, Nr.01/1097, të datës 24.07.2018; deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmëris së fondeve të datës 09.08.2018; Kontratë prokurimi Nr.79, me shenjen Nr.03/123 e datës 26.10.2018, Kërkesë Nr.01-1597, të datës 06.11.2018; Raporti i punimeve për projektin “Shkolla fillore në ....., i datës 15.05.2018 (2019) dhe Kopje e planit të parcelës për ndërtimin e shkollës në ....., i datës 23.05.2018, Agjencia Kadastrale, të gjitha këto të administruara në cilësinë e provave materiale e nga të cilat ka vërtetuar faktin iniciimi i procedurës së prokurimit, në emër të realizimit të projektit për ndërtimin e objektit të ri shkollor në fshatin ....., ishte bërë në muajin korrik të vitit 2018, ndërsa që kërkesa për marrjen e vendimit për ndërrimin e pronës publike në pronë private, i ishte paraqitur Kuvendit Komunal në muajin nëntor të vitit 2018, pra disa muaj pas që ishte iniciuar procedura e prokurimit dhe pasi që ishte nënshkruar kontrata, dhe për me tepër pasi që i akuzuari R.B, kishte lidhur marrëveshje gojore me tani të dëmtuarin B.R, për kompensim përkatësisht këmbim të tokës me tokë, duke anashkalluar kështu Kuvendin Komunal si organ kompetent për vendosur në çështje të kësaj natyre dhe vetëm pas përfundimi të procedurës së

prokurimit, ka kërkuar nga Kuvendi Komunal që të shpallet zonë me interes të veçantë sipërfaqja prej 836m<sup>2</sup>, në parcelën në emër të tani të dëmtuarit B.R, edhe pse veprimi parë që është dashur të bëhet është pikërisht paraqitja e kësaj kërkesë, dhe në varësi të vendimi të Kuvendit Komunal, të filloj procedura tjera të nevojshme për realizimin e projektit përkatës. I akuzuari R.B duke arritur marrëveshje gojore me tani të dëmtuarin B.R, ka tejkalluar autorizime e tij ligjore, pasi që nuk ka pasur të drejte të marr obligim të kësaj natyre, meqenëse këmbimi i tokës me tokë, është kompetencë e Kuvendit Komunal, dhe pikërisht duke e paraqitur kërkesën në Kuvendin Komunal, i akuzuari R.B e ka ditur se është ne tejkallim të autorizimeve të tij ligjore, është duke uzurpuar kompetencat e një organi tjetër, dhe me këtë është duke i shkaktuar dëm tani të dëmtuarin meqenëse, të njëjtis është duke ju marr toka, mirëpo kompensimi qoftë në mjete financiarë apo edhe në këmbim me tokë tjetër, nuk mund të behet me marrëveshje gojore, se vendimet e Kuvendit Komunal janë përfundimtare, e që pikërisht duke pasur parasysh këtë, siç ka dëshmuar edhe vetë i dëmtuari B.R, deri me tani nuk është kompensuar në asnjë lloj forme për pjesën e tokës së marr për ndërtimin e objektit shkollor.

Nga Procesverbalet mbledhjeve të Kuvendit Komunale në Komunën e .....: Nr.02/283, datë 14.05.2019; Nr.02/461, datë 07.11.2018; Nr.02/489 datë 23.11.2018; Nr.02/489 datë 23.11.2018; Nr.02/508, datë 04.12.2018; Nr.02/508, datë 04.12.2018, Nr.02/583, datë 31.12.2018; Nr.02/146, datë 23.01.2019; Nr.02/107 datë 22.02.2019; Nr.02/189 datë 22.03.2019; Procesverbal Nr.02/194 datë 22.03.2019; Nr.02/341 datë 05.06.2019; Nr.02/345 datë 10.06.2019, Nr.02/285 datë 13.05.2019, Shkresa Nr.02/367,Nr.02/367, datë 20.06.2016, Nr.025/189 datë 22.03.2019, Procesverbal Nr.02/549 datë 10.09.2019, Nr.02/461, datë 07.11.2018; Nr.02/489, datë 23.11.2018; Nr.02/46, datë 23.01.2019; Nr.02/107, datë 22.09.2019, vërtetohet se në të gjitha këto mbledhje, përgjatë viteve 2018-2019 është propozuar në rend të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1597, i datës 06.11.2018 e parashtruar nga Kryetari i komunës, për ndërrimin e pronës publike me pronë private për interes publik, me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin ....., KK-..... E që në vazhdimësi është refuzuar që e njëjta të trajtohet, duke mos pranuar që të miratohet si pikë e veçantë e rëndit të ditës për diskutim.

Gjykata ka vlerësuar të gjitha këto procesverbale të mbledhje të Kuvendit Komunale në Komunën e ....., nga të cilat ka vërtetuar se tani i akuzuari R.B, disa herë ka paraqitur kërkesë për futjen në rendin e ditës, të kërkesës për ndërrimin e pronës publike me pronë private për interes publik, me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin ....., KK-....., kërkesë kjo e cila ishte refuzuar në vazhdimësi, nga Kuvendi Komunal, meqenëse një kërkesë e tillë, ishte paraqitur pasi që ishin zhvilluar dhe përfunduar të gjitha procedurat e prokurimit lidhur me ndërtimin e asaj shkolle, për me tepër ishte nënshkruar edhe kontrata me operatorin e caktuar ekonomik, duke e anashkalluar kështu në tërësi Kuvendin Komunal, i cili edhe ka kompetencë ekskluzive për shpallen e një zone me interes të veçantë, e që kjo duhet të bëhet fillimisht, përkatësisht duhet të ju pri të gjitha procedurave tjera, përmes saj është dashur të përcaktohet vendi i ndërtimit të objektit shkollor, e pastaj të vazhdohet me procedurat e kompensimit financiar apo këmbimi të tokës, dhe jo që i akuzuari R.B, të mjaftohet me arritjen e marrëveshjes gojore për mënyrën e kompensimit, duke pasur parasysh se është kompetencë e Kuvendit Komunal të vendos, fillimisht për shpalljen zona të veçantë, dhe pastaj të vazhdohet me procedura tjera. Duke paraqitur këto kërkesa të vazhdueshme, vërtetohet bindshëm fakti se i akuzuari R.B, e ka ditur dhe me qëllim e ka anashkalluar Kuvendin Komunal, duke tejkalluar autorizimet e tij lidhore, veprime këto që ka tentuar të ju jap mbulesë ligjore përmes paraqitjes së kërkesës për shpallje zonë me interes të veçantë sipërfaqja prej 836m<sup>2</sup>, në parcelën në emër të tani të dëmtuarit B.R, pasi që vetë ka caktuar lokacionin, e ka zhvilluar procedurat e prokurimit, e ka lidhur kontratën me operatorin e caktuar ekonomik.

Nga Ekspertiza e ekspertit financiar A.SH e datës 17.11.2020, vërtetohet se në të njëjtën është konstatuar se kryetari i komunës së ..... i pandehuri R.B ka marrë vendim në kundërshtim me Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës Komunale, Ligjin për Vetëqeverisjes Lokale, Ligjin për buxhetin e vitit 2018, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi 03/L-048 , Ligji për Financat e Pushtetit Lokal 03/L -49 , Ligji për Prokurim Publik 03/L042, i ndryshuar dhe amendamentuar, Rregulloren dhe Statusin e Komunës së ....., për faktin se tani i akuzuari R.B në cilësinë e personit zyrtar të Kryetarit të Komunës ka marrë vendim që objekti i shkollës të ndërtohet në pronë private pa u tjetërsuar apo ndërruar prona, si dhe ka anashkaluar vendimet e Kuvendit Komunal lidhur me ndërtimin e sallës sportive duke marrë vendim të njëanshëm, dhe si rezultat i kësaj salla sportive nuk është ndërtuar. Njëkohësisht ka marrë vendim për bartje të mjeteve financiare nga një program në tjetër apo një kod në një kod tjetër, ka ndikuar që raporti financiar i komunës të mos prezantoj gjendjen reale të shpenzimeve sipas rregullave financiare. Pastaj, është konstatuar se Zyrtari Kryesor Administrativ - Kryetari i Komunës është përgjegjës për vendosjen i kontroleve të brendshme financiare për të menaxhuar rreziqet dhe ofruar siguri të arsyeshme që buxheti dhe burimet e tjera do të përdoren në mënyrë të rregullt, etike, ekonomike, efektive dhe efikase drejtë arritjes së objektivave. Po ashtu, është konstatuar se Kryetari i Komunës, R.B duke anashkaluar ligjet dhe rregulloret në fuqi, i ka krijuar komunës së ..... detyrime kontingjente për shkak se ka ndërtuar objekt shkollor në pronë private pa përfillur dispozitat ligjore.

Gjykata ka dëgjuar ekspertin A.SH, në seancën e datës 10.03.2022, ku i njëjti ka deklaruar se punon Zyrtarë Kryesor Financiar në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik, dhe se edhe në të kaluarën ka përpiluar ekspertiza për nevoja të institucioneve publike, përfshirë Prokurorit të shtetit dhe Gjykatës. Ka shtuar se ligji i prokurimit publik parashikon se nënshkrimi i kontratave publike në emër të autoriteteve kontraktuese e nënshkruan vetëm menaxheri i prokurimit edhe në rast se kontratat janë në vlera të mëdha edhe ZKA, e që në rastin konkret është Kryetari i Komunës dhe ligji nuk e lejon që të delegohet apo të autorizohen persona për nënshkrimin e kontratave publike, ku shprehimisht thuhet se çdo kontratë publike e nënshkruar përveç personave të theksuar konsiderohet kontratë jo ligjore. Çdo pagesë sipas rregullave në autoritete publike, konkretisht në organizatat buxhetore që shpenzojnë fondet publike, inicimi i një shpenzimi apo aprovimi respektivisht miratimi i atij shpenzimi bëhet nga ZKA, në rastet e delegimeve të përgjegjësi autorizimi apo aprovimi bëhet nga personat përgjegjës që ju kanë deleguar këtë përgjegjësi, me pas në procedurë të shpenzimeve përfshihet edhe zyrtari zotues, zyrtari shpenzues dhe përfundimisht zyrtari certifikues. Më tutje sa i përket konstatimit në ekspertizë lidhur me Sallën e Rinisë dhe Sporteve në fshatin ....., te shkolla “.....”, ka theksuar se Ministria e Kulturës ka pasur me financuar projektin, pra ka ndarë mjete për ndërtimin e sallave të sportive, ka pasur një memorandum me Komunën për financim të këtij projekti dhe ka kërkuar nga Komuna që paraprakisht të kryhen disa procedura në mënyrë që të implementohet projekti, dhe njëra prej tyre ka qenë që të përcaktohet lokacioni për arsye se në Ministrinë e linjës nuk mund të financojnë projekte ku nuk dihet ku dhe çka ka me u financuar, për këtë projekt Asambleja Komunale ka miratuar një pronë apo lokacion tjetër gjë që nuk është miratuar nga Kryetari i Komunës dhe si i tillë objekti nuk është finalizuar për faktin se Ministria e linjës i ka tërhequr fondet, për shkak se Komuna nuk i ka plotësuar kërkesat për të vazhduar apo proceduar me investime. Po ashtu lidhur me konstatimin në raportin e ekspertizës, ku theksohet se janë bërë pagesa të ndryshme për investime të ndryshme ku nuk janë realizuar projektet, ka theksuar se shembull konkret është projekti për ndërtimin e Shkollës “.....”, dhe në emër të këtij projekti janë bërë pagesat që janë pasqyruar për shpenzime krejtësisht tjera, duke filluar nga riparimi i ngrohjeve, drekave zyrtare, renovimi i Shkollës “.....”, Shkollës “.....” etj, që do të thotë se këto shpenzime nuk janë bërë në përputhje me

projektin që është miratuar me buxhet, dhe kjo është jo në përputhje me ligjin e buxhetit për vitin përkatës, është në kundërshtim me rregulloren 01/2013, për shpenzimin e parasë publike, pasi që nuk lejohet paratë e një projekti të barten pa miratim apo të shpenzohen pa miratim paraprak në projekte apo shpenzime tjera, e atë me keq në kategorinë për mallra dhe shërbime. Ka theksuar se rregullat financiare nuk lejojnë që të bëhen pagesa nga një kategori në kategorinë tjetër pa miratimet paraprake, coftë nga Kuvendi Komunal, Ministria e Financave apo Kuvendi i Kosovës i cili e ka miratuar atë ligj. Po ashtu ka sqaruar se Ligji për Dhënien dhe këmbim të pronës publike neni 11, që i lejon autoriteteve publike me ndërruar prona kur është interesi publik, coftë me i marrë pronari privat i tokës në këmbim të pronës publike, që do të thotë më i dhënë ose me i marrë varësisht si është interesi, por këmbimet apo ndërrimet e pronës Komuna ka për obligim me krijua një komision dhe me bë vlerësimin e atyre pronave, pra me bë një analizë apo studim fizibiliteti dhe me vlerësua se cili është interesi i Komunës për ndërrimin e asaj pronës dhe sa është vlera monetare e saj varësisht nga çmimi i tregut, dhe me pastaj ai vlerësim shkon në Asamble Komunale dhe duhet me marrë pëlqimin apo miratimin e Asamblesë në mënyrë që prona të konsiderohet si e ligjshme për autoritetin apo Komunën, e më pas janë ato procedurat që konsiderohen teknike që prona publike mu shndërruar në pronë private apo prona private në atë publike, duhet të përcaktohet thjeshtë titullari i asaj prone pastaj të veprohet me ndërtim apo të merren leje për shfrytëzim për çka ka qenë interesi i Komunës. Në fund ka shtuar se qëndron mbrapa në tërësi të gjitha konstatimeve të dhëna në ekspertizë, se më të njëjtën nuk ka përcaktuar asnjë dëm të shkaktuar, por kam konstatuar anashkalim të dispozitave ligjore që më vonë mundën me pas pasoja ose dëme.

Gjykata ka vlerësuar edhe ekspertizën e ekspertit financiar A.SH e datës 17.11.2020, të administruara në cilësinë e provës materiale, si dhe shpjegimet shpesh të dhëna nga eksperti financiar A.SH në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e të njëjtat i ka gjetur, si reale dhe objektive, që si përfundime të tilla, janë arritur mbi premisa të të qarta dhe të bazuara, me të dhëna konkrete, e shpjegime shteruese, lidhur me të dhënat e referuara, e nga të cilat ka vërtetuar bindshëm faktin se i akuzuari R.B në cilësinë e kryetarit të Komunës së ....., në shkelje të dispozitave ligjore dhe rregulloreve në fuqi ka marrë vendim që objekti i shkollës të ndërtohet në pronë private pa u tjetërsuar apo ndërruar prona private e familjes ....., duke krijuar kështu detyrimet kontingjente për komunën, e cila familjes ....., i ka marr sipërfaqen e parcelës, në mungesë të kompensimit, duke u mjaftuar me marrëveshje gojore të cilat nuk prodhojnë asnjë efekt ligjor, pastaj ka anashkaluar vendimet e Kuvendit Komunal lidhur me ndërtimin e sallës sportive duke marrë vendim të njëanshëm, dhe si rezultat i kësaj salla sportive nuk është ndërtuar, si dhe ka marrë vendim për bartje të mjeteve financiare nga një program në tjetër apo një kod në një kod tjetër, edhe pse nuk ka pas autorizim ligjor për një veprim të tillë.

Nga Njoftimet për kryetarin e komunës, të datave 06.06.2019 dhe Nr.04-122, i datës 04.07.2019, nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa-Komuna e ....., për kryetarin e Komunës tani të akuzuarin R.B, vërtetohet se të njëjtave i janë bashkangjitur raportet e pagesave sipas SIMFK-së për pagesat në kodin ekonomik 13460 “shërbime kontraktuese tjera” si dhe projektin me nr.46734 “Rregullimi i shtratit të Lumit Mirusha”, i cili konstatohet si projekt i përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i projektit.

Kërkesë e biznesit NT “ .....” drejtuar Ministrisë së Financave për pagesë për shkak të mos kryerjes së pagesës në shumë prej 25,036.83 euro nga komuna e ..... (me dosje e kompletuar për pagesë)Nr.4019, i datës 01.11.2019, Biznesi, NT“ .....”.

### **Vlerësimi ligjor**

Pas procedimit të të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit

361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në aktgjykim, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë faktike, të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë lidhur me këtë çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të akuzuarve R.B manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPPRK-së.

Vështruar nga cilësimi juridik i veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPPRK-së, sipas dispozitave ligjore të nenit 422 të KPPRK-së, kjo vepër penale ekziston kur personi zyrtar a përgjegjës, duke shfrytëzuar pozitën e vet zyrtare apo autorizimet, me tejkalimin e kufijve të autorizimeve të tij, ose duke mos i kryer detyrat e veta zyrtare, përfiton për vete a për tjetrin “ose organizatën e biznesit” çfarëdo dobie, i shkakton dëm tjetrit ose shkel seriozisht të drejtat e personit tjetër, pra veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative, dhe vepra penale paraqitet në tri forma, që janë: shfrytëzimi i pozitës zyrtare (shpërdorim) apo autorizimeve, tejkalimi i autorizimeve zyrtare dhe mos përmbushja e detyrave zyrtare (moskryerja e detyrimeve zyrtare). Në rastin konkret lidhur me të akuzuarin R.B, jemi në kushtet e kryerjes se kësaj vepre penale në atë mënyrë që duke shfrytëzuar pozitën zyrtare apo autorizimet e tyre, ka tejkaluar autorizimet e tij zyrtare dhe po ashtu nuk i ka përmbushur detyrat e tij zyrtare, ashtu që ka kryer veprime jashtë autorizimeve të tij ligjore në njërën rast, ndërsa që në rastin tjetër nuk i ka përmbushur detyrat e tij zyrtare. I akuzuari R.B duke tejkaluar detyra e tij zyrtare, qëllimisht nuk i ka zbatuar drejtë dispozitat e LPP-së dhe ligjit 04/L-144, për caktimin e lokacionit se ku do të ndërtohet shkolla në fshatin ....., e ka anashkaluar Kuvendin Komunal, si i vetëm organ përgjegjës për të marr vendime të kësaj natyre, ashtu që ka arritur një marrëveshje gojore me përfaqësuesin e familjes ....., të cilës i ka takuar prona, pastaj me datë 13.08.2018, ka publikuar tenderin me titull “Ndërtimi i Objektivit të Shkollës Filllore në fshatin .....” me nr. prokurimi 62500-18-5890-5-1-1, me ç’rast në dosjen e tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, ka munguar projekti ekzekutues-zbatues, ashtu siç kërkohet me rregullat e Ligjit për Prokurim Publik, nuk ka qenë e caktuar as parcelën se ku do të ndërtohet kjo shkollë, dhe nënshkrimi të kontratës Nr.03/123, të datës 30.08.2019, me nr. identifikues 62500.18.141.511, të cilën nuk e ka nënshkruar Menaxheri i Prokurimit por në vend të tij kontratën e ka nënshkruar zyrtari B.K, në kundërshtim me nenin 26 të LPP-së, ndërsa që kërkesën për shpallje të pronës private në zonë me interes publik, ka bërë me datë 06.11.2018. Pra i akuzuari R.B, fillimisht ka caktuar vetë lokacionin, siç rezulton nga marrëveshja gojore me përfaqësuesin e familjes ..... tani të dëmtuarin B.R, duke tejkaluar kështu autorizimet e tij zyrtare dhe duke bërë uzurpimin e kompetencave të një organi tjetër, pas duke hyrë në marrëveshje gojore, ka shkelur në mënyrë flagrante dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me procedure e shpronësimit apo këmbimit të pronës, dhe pas përfundimit të procedurës së prokurimit, e cila po ashtu është zhvilluar në shkelje të dispozitave ligjore pasi që në dosjen e tenderit nuk ka ekzistuar fare projekti ekzistues, dhe se kontrata është nënshkruar nga personi i cili nuk ka gazuar autorizime ligjore për ta nënshkruar të njëjtën, ndërsa që vetë i akuzuari R.B, në cilësinë e zyrtarit kryesor administrativ, ka pasur detyrim ligjor të kujdeset për respektimin e dispozitave ligjore me rastin e zhvillimit të procedurës së tenderimit.

Po ashtu, i akuzuari R.B, ka tejkaluar autorizimet e tij zyrtare, me rastin e nxjerrës së aktvendimit Nr.01-1559, për lejimin e pagesave nga kodi në kod dhe projekti në projekt, pasi që ndryshimet eventuale të buxhetit dhe bartja e parave nga një kod buxhetor në kodin tjetër bëhen vetëm përmes votimit në Kuvendin Komunal dhe në asnjë mënyrë me vendime të kryetarit për shkak se nuk është brenda kompetencave të tij, siç përcaktohet me nenin 13, 24 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 (ligji për vetëqeverisjen lokale), dhe pastaj mjetet financiare nga projektet kapitale të aprovuara nga Kuvendi Komunal, janë përdorur për pagimin e shpenzimeve përmbartimore, që siç vërtetohet edhe përmes ekspertizës financiare , shpenzimet janë paguar nga investimet kapitale si salla e sporteve, rrugë, kanalizime, objekte shkollore.

Po ashtu i akuzuari duke mos vepruar në përputhje me detyrën e tij zyrtare, ka refuzuar të zbatoj vendimin e Kuvendit Komunës Nr.02/135 të datë 04.05.2018, për ndërtimin e Sallës së sporteve në fshatin ....., në oborrin e shkollës “.....”, ani pse detyrimin e tij ligjor për zbatimin e këtij vendimi, i është konfirmuar edhe nga Ministria e Administratës dhe Pushteti Lokal përmes shkresës së datës 06.12.2018, sipas të cilës vendimet e Kuvendit Komunal janë të detyrueshme, për më tepër, i akuzuari R.B, në tejkallim të detyrës zyrtare, ka nxjerr vendimin nr.01/1527 i dt.23.10.2018, që kjo palestër të ndërtohet te shkolla fillore “.....” në .....

I akuzuari R.B, ka qenë në dijeni, se është përgjegjës për zbatim të vendimeve të Kuvendit Komunal, përkatësisht se për çështje të caktuara siç janë edhe shpalla e vendeve të caktuara zona me interes të veçantë, pastaj ndarjes së lokacioneve për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin ....., si dhe bartjen e mjeteve financiare nga një kod buxhetor në tjetrin, kompetencë ekskluzive ka Kuvendi komunal për të vendosur, kjo dijeni e tij rezulton edhe nga fakti që i njëjti pas ndërmarrjes së veprimeve ka kërkuar nga Kuvendi Komunal që të nxjerr vendime të caktuara, siç është rasti me ndërtimin e shkollës në fshatin ....., ku pas lidhjes së kontratës me datës 26.10.2018, i është drejtuar kuvendit Komunal me kërkesë për Kërkesë Nr.01-1597, e datës 06.11.2018, për marrjen e vendimit për ndërtimin e pronës publike në pronë private, pastaj në rastin e ndërtimit të sallës së sporteve ku i është drejtuar Kuvendit Komunal me kërkesë për shqyrtim të vendimit nr.02/135, të datës 04.05.2018, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin ....., dhe pasi që është vendos ndërtimi i sallës sportive në një vend tjetër, ka refuzuar zbatimin e këtij vendimi dhe ka nxjerr vendim për ndërtimin e sallës së sporteve, aty ku vetë ka kërkuar, në oborrin e shkollës “.....”, pra ky i akuzuar, ka qenë plotësisht në dijen për detyrimet dhe autorizime e tij ligjore, mirëpo që meqenëse qëllime dhe dëshirat e tij, kanë qenë përtej autorizimeve ligjore, atëherë, ka vendosur që Vendimet e Kuvendit Komunal të mos i zbatoj, të uzurpoj autorizimet e këtij organi dhe vetë të vendos, për çështje për të cilat nuk ka pasur kompetencë dhe autorizime ligjore në cilësinë e kryetarit të Komunës së .....

### **Mbrojtja e të akuzuarit**

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit R.B, të paraqitur përmes av.E.K dhe vet të akuzuarit R.B të dhënë në procedure paraprake, mirëpo të njëjtën e ka gjetur të pabazuar, dhe në funksion të ikjes së përgjegjësisë penale, për veprën penale për të cilën është akuzuar. Mbrojtja pretendon se lidhur me ndërtimin e shkollës në fshatin ....., vetë i dëmtuari ka dhënë pëlqimin për ndërtimin e shkollës në parcelën pronë e familjes së tij, kundrejt kompensimit apo këmbimit të tokës me tokë, mirëpo mbrojtja anashkalon faktin që sikurse në rastin e këmbimi ashtu edhe të kompensimit, duke të zhvillohet procedurë e caktuar ligjore, se nuk mjafton dakordimi i disa zyrtarëve, siç mbrojtja pretendon se ka ndodhur në rastin konkretë, përderisa kjo ka qenë kompetencë e kuvendit Komunal, ndërsa që marrëveshjet gojore, as nuk janë nevojshme dhe as të mjaftueshme, meqenëse me dispozita ligjore është parashikuar procedura caktuar se si vepron në raste të kësaj natyre. Po ashtu pretendimi i mbrojtjes se i mbrojturi i tij nuk ka vepruar në kundërshtim me vendimin nr.02/135, të datës 04.05.2018, pasi që kryesia e fshatit ..... ka vendosur se salla e sporteve të ndërtohet në oborrin e shkollës “.....”, të këtij fshati dhe se kanë qenë shkaqet politike që është vendosur nga Kuvendi Komunal që salla e sporteve të ndërtohet në oborrin e shkollës “.....”, nuk qëndron, kjo duke pasur parasysh se nuk ka qenë në kompetencë të kryesisë së fshatit vendos lidhur me lokacionin e ndërtimit, dhe këtë fakt e ka pasur të njohur edhe vetë i akuzuari R.B, i cili me kërkesë i është drejtuar Kuvendit komunal për të vendosur lidhur me këtë, dhe jo kryesisë së fshatit siç pretendon mbrojtësi i tij, ndërsa që referimi në shkaqe apo mos pajtime politike, për të ju shmangur dispozitave ligjore, sa është i paarsyeshëm është edhe i paqëndrueshme, meqenëse, me një logjik të tillë, duke u mjaftuar me kualifikimin e vendime të caktuar të një organi të autorizuar për të marr vendime të tilla, si të motivuara politikisht, atëherë lind e drejta për moszbatim të tyre apo uzurpim të

kompetencave të këtij organi, duke vendosur në emër të tij, siç ka vepruar i akuzuari R.B, kur ka nxjerr vendimi për ndërtimin e sallës së sporteve në oborrin e shkollës “.....”. Mbrojtja në gjithë pretendimet e saj, i referohet interesit publikë, e në këtë drejtim edhe sa i përket vendimit lidhur me transferimin e mjeteve financiare nga një kod buxhetor në tjetrin, kjo arsyetohet me interesin publik dhe ruajtën e buxhetit të Komunës, mirëpo nuk është provuar fare që këto ndryshme të nevojshme, e siç thotë mbrojtja në interes publik të bëhen në respektim të dispozitave ligjore, përmes procedimit të kërkesës për ndryshim në Kuvendin Komunal, si i vetëm organ i autorizuar për të marr vendime të kësaj natyre. Gjykata e njehë dhe e kupton interesin publikë, mirëpo thekson se respektimi ligjit dhe procedurave ligjore, është interesi më i lartë që duhet të mbisundojë në çdo rast dhe se nuk është në të drejtën e zyrtarëve publik të vendosin nëse duhet apo kur duhet të zbatohen dispozitat ligjore, e kur duke u mbështetur gjoja në interes publik të shmanget zbatimi i të njëjtave, por veprimi në zbatim të ligjit duhet të jetë e vetmja formë e veprimit në të gjitha çështje dhe për të gjitha rastet.

Me rastin e vlerësimit të rrethanave të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të akuzuarin R.B në kuptim të nenit 73 të KPPRK-ës, gjykata ka vlerësuar si rrethana veçanërisht lehtësuese, moshën dhe gjendjen e rënduar shëndetësore të akuzuarit R.B, gjendje kjo e vërtetuar edhe nga dokumentacioni mjekësor në shkresat e lëndës, e që bazuar në këtë rrethanë ka vendosur minimumin e dënimit e paraparë për këtë veprë penale, e duke i dhënë mundësi të akuzuarit që me pëlqimin e tij, i njëjti të i zëvendësohet me dënim më gjobë në shumën e përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Pastaj si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur faktin se i akuzuari nuk kanë qenë më parë i gjykuar apo të dënuar për ndonjë veprë tjetër penale, sjelljen korrekte e akuzuarit gjatë zhvillimit të kësaj procedure penale, si dhe sjelljen e tij pas kryerjes së kësaj veprë penale. Ndërkaq, në mungesë të rrethanave rënduese si rrethana rënduese, e bazuar në këto rrethana gjykata i ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i shqiptuara, është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin të njëjtit, si dhe do të ndikojë në vetëdijesimin dhe përmbajtjen e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale, si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së, ndërsa që vendimi për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit është marr sipas Ligjit nr. 05/L-036, për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil, është marrë pasi që pala e dëmtuar nuk e ka precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, dhe duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që, të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë lidhur me këtë çështje, konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti Special**  
**PS.nr.12/21, datë 14.04.2022**



Numri i lëndës: 2020:058602  
Datë: 20.04.2022  
Numri i dokumentit: 02934354

**Bashkëpunëtori profesional**  
Driton Berisha

**Kryetarja e trupit gjykues– gjyqtarja**  
Violeta Namani-Hajra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.